

1 E mërkurë, 8 shtator 2021

2 [Konferencë përgatitore e Prokurorisë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Haradinaj nuk merr pjesë]

5 --- Fillon në orën 09.30

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirëdita dhe mirëserdhët të
7 gjithë.

8 Zonja sekretare e gjykatës, a mund të deklaroni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 U lutem, palëve që të na informojnë nëse ka anëtarë të
14 rinj, të cilët do të donit t'i prezantonit.

15 Prokuror, keni?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Një
17 ndryshim nga java që shkoi, znj. Line Pedersen nuk ndodhet sot
18 këtu por po zëvendësohet nga Clemence Volle-Marvaldi.

19 Z. REES: [Përkthim] Unë sot ndihmohem, asistohem krahas
20 të tjerëve dhe nga z. Muharrem Halilaj, z. Faye.

21 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Ka vetëm një ndryshim, z. Buckley,
23 nuk ndodhet këtu me mua sot, do të jetë nesër.

24 Për hir të procesverbalit, z. Haradinaj dëshironte që t'i
25 përcillte Gjykatës këtë mesazh, se edhe pse ai nuk ka

1 kundërshtim kundër Trupit Gjykses, ai, gjithsesi, ka
2 shqetësime serioze sa i takon sjelljes së Prokurorit prandaj
3 dhe nuk ndodhet këtu sot. Refuzon që të marrë pjesë sot dhe
4 nesër.

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Vë re që z. Gucati ndodhet në sallën e gjyqit sot dhe për
7 hir të procesverbalit, vëmë re që z. Haradinaj ka hequr dorë
8 nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm.

9 Siç e dini të gjithë, javën që shkoi Trupi Gjykses
10 zhvilloi konferencën përgatitore për gjykimin në këtë çështje
11 gjyqësore dhe lëshoi disa urdhra gojarisht për hapat në vijim.
12 Gjithashtu, Trupi Gjykses ka lëshuar dhe dy urdhra me shkrim,
13 një për arsyet për mosmiratimin e masave mbrojtëse të kërkuara
14 nga ZPS-ja për dëshmitarët e saj dhe një, për njoftimin e
15 hollësishëm të rregullit 102(3).

16 Në përputhje me rregullin 116(2) të Rregullores një
17 konferencë përgatitore për ZPS-në duhet të zhvillohet brenda
18 30 ditësh nga konferenca përgatitore për gjykimin ose siç
19 urdhëron Trupi Gjykses. Prandaj, Trupi Gjykses, pas seancës me
20 palët, e organizoi brenda një jave konferencën përgatitore për
21 ZPS-në.

22 Do të fillojmë me temën e parë për problemet në vijim sa
23 i takon nxjerrjes.

24 Zoti prokuror, në këto ditë që kanë kaluar, zyra juaj ka
25 nxjerrë paketa të reja me numër 42 deri në 44. Trupi Gjykses

1 kupton se pra, është në dijeni se paketa 43, 44 kanë lidhje me
2 kërkesën e ZPS-së për të shtuar një dëshmitar në listën e vet
3 në varësi të kërkesës.

4 Sa i takon paketës 42, ky duket se aty përmban një
5 deklaratë të punonjësit të ZPS-së, i cili deklaron se, pra, sa
6 i takon paketës 42 duket se ajo përmban një deklaratë të një
7 punonjësi të ZPS-së i cili deklaron se "nuk ka thënë kurrë se
8 dokumentet mund të mbahen në OVL-UÇK për një muaj" dhe kështu
9 ka parashtruar këtë në kuadër të rregullit 102(3).

10 A ka ndonjë nxjerrje tjetër që pritet nga ZPS-ja për
11 këtë?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, me sa jemi ne në dijeni, i
13 nderuar Gjykatës. Ne sigurisht, e kemi parasysh njoftimin e
14 rregullit 102(3) lidhur me vendimin e djeshëm dhe po
15 vlerësojmë sesi do të veprojmë në bazë të këtij vendimi.

16 Po kështu, është dhe një përjashtim lidhur me atë që e
17 kam përmendur tani sa i takon kërkesës së palëve të treta.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po, në rregull faleminderit.

19 Doni të shtoni diçka z. Rees?

20 Z. REES: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

21 Ne kemi marrë edhe urdhrin e Trupit Gjykues dje, sa i
22 takon njoftimit të rregullit 102(3), kërkesa për njoftim të
23 hollësishëm që ka të bëjë me ato çështje që ka identifikuar më
24 parë Gjykata e Apelit si të rëndësishme.

25 Ne mbetemi në pritje që të shohim se çfarë do të marrim

1 në lidhje me këtë urdhër në mbyllje të ditës nesër dhe unë
2 mendoj se urdhri kërkon njoftim të redaktuar të rregullës
3 102(3) në përputhje me shtojcën konfidenciale që ishte shtojca
4 e urdhrit. Kështu që unë nuk mund të them asgjë më shumë
5 lidhur me këtë si temë në veçanti, por dëshiroj që t'i
6 rikthehem njoftimit të rregullës 102(3) në tërësi, jo thjesht
7 për të folur për ato çështje të cilat kanë qenë objekt i
8 vendimit të Gjykatës së Apelit në veçanti, procesi përmes të
9 cilit informacioni ka shkuar në mjediset e OVL-UÇK-së por e
10 kam fjalën për njoftimin e rregullit 102(3) në përgjithësi.

11 Në këtë njoftim duhet që të listohen të gjitha materialet
12 e rëndësishme që ka në zotërim Prokuroria. Nuk do t'i kthehem
13 kësaj çështjeje sepse parimi është përcaktuar tashmë nga
14 vendimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake, nga paneli i
15 Gjykatës së Apelit dhe sigurisht është zbatuar dhe nga Trupi
16 Gjykues në vendimin që ju nxorët dje.

17 Por na duket se ka një shqetësim real lidhur me faktin
18 nëse ZPS-ja e ka zbatuar apo jo këtë parim.

19 I nderuar Gjykatës sapo përmendi paketën 43 të nxjerrjes.
20 Kjo është bërë më datë 3 shtator 2021. Ka të bëjë me një
21 intervistë të dëshmitarit që është zhvilluar më 25 mars 2021
22 dhe provat materiale që kanë dalë nga ky dëshmitar gjatë kësaj
23 interviste.

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Gjykatësi Mettraux ka kërkuar
25 leje që të ndërhyjë për të bërë një pyetje.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe unë kam të njëjtin
2 supozim. Më duket se data ka një gabim në pjesën e sipërme të
3 dokumentit. Po të shihni rreshtat në vijim thotë "25 gusht"
4 dhe poshtë në pjesën e poshtme të dokumentit thotë të njëjtën
5 gjë. Edhe unë kështu e kuptova gabimisht në fillim, po në fakt
6 duket se është thjeshtë procesverbali i intervistës që është
7 zhvilluar më datë 25 gusht.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe unë do të doja të thosha që
9 është e saktë ajo që thotë Gjykatësi.

10 Z. REES: [Përkthim] Por, shqetësimi mbetet i njëjtë. Nuk
11 jemi njoftuar për këtë dhe na është dorëzuar materiali më datë
12 3 shtator.

13 E ngre këtë pyetje, nëse ZPS-ja i ka listuar të gjitha
14 materialet përkatëse sipas rregullit 102(3) në njoftimin
15 përkatës të këtij rregulli. Njoftimi i rregullit 102(3)
16 sigurisht, kërkon njoftim të të gjitha materialeve të
17 rëndësishme sapo të jetë mundur, sapo që Prokuroria e ka këtë
18 material. Kjo, në fakt, nuk është bërë në këtë rast dhe unë e
19 nxis ZPS-në që të bëjë një shqyrtim të materialeve që ka në
20 zotërim për të parë nëse ka çështje të tjera të cilat do të
21 duhet të përfshiheshin në njoftimin e rregullit 102(3) krahas
22 çështjeve që janë ngritur në urdhrin që mbulonte -- në urdhrin
23 që ka nxjerrë Trupi Gjykses dje, - më falni.

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

25 Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

2 Njësoj si z. Rees, edhe unë isha përgatitur që të
3 merresha me çështjet e nxjerrjes sot, po duke pasur parasysh
4 vendimin që keni nxjerrë ju, jam në pritje të shoh se çdo të
5 na dorëzojë Prokuroria.

6 Por, unë kam të njëjta shqetësime si z. Rees. Sidomos
7 diçka të cilën do të na duhet ta shohim në një moment tjetër
8 më pas mbase jo tani, por javën që shkoi, z. Halling, në emër
9 të Prokurorisë disa herë tha se shënimet e kontaktit me
10 dëshmitarët nuk përfshinin ndonjë procesverbal interviste apo
11 ndonjë deklaratë të marrë. Në fakt, se nuk ishin zhvilluar
12 intervista me këta dëshmitarë, në përgjithësi nuk kuptoj qartë
13 nëse kishte apo jo dëshmitarë.

14 Dua që ta sjell këtë në vëmendjen e Trupit Gjykses. Në
15 seancat e mëparshme, të paktën në janar të këtij viti, ZPS-ja
16 u shpreh shumë qartë, se po intervistonin dëshmitarë. Dhe siç
17 e ka thënë z. Rees disa herë, është bërë e qartë se deri në 10
18 dëshmitarë, pra, dëshmitarë për të konstatuar faktet, kishte
19 gjasa se do të prezantoheshin dhe do të na dorëzoheshin
20 deklaratat e tyre.

21 Por unë e ngre këtë tani sepse ka një shqetësim nëse janë
22 marrë apo jo deklaratat këtyre dëshmitarëve, janë intervistuar
23 këta dëshmitarë apo jo. Apo Prokuroria do mbështetet vetëm në
24 shënimet e kontaktit. Pra, duam që ta shprehim këtë shqetësim
25 për mospërputhje midis asaj që i është deklaruar Gjykatës më

1 përpara dhe asaj që ju tha Trupit Gjykues javën që shkoi.

2 Prandaj dhe duhet bërë një kërkesë tjetër për nxjerrje

3 kundrejt Prokurorisë në bazë të atyre që kanë thënë.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Në lidhje me atë që kanë thënë të
5 dy avokatët.

6 Mbrojtja e Gucatit nuk paraqet bazë për t'ju rikthyer
7 njoftimit të rregullit 102(3). Ka një aspekt të këtij njoftimi
8 për të cilin është mirë në dijeni Trupi Gjykues. Paketa 43 e
9 nxjerrjes nuk krijon çështje të reja në dukje. Është një
10 intervistë e zhvilluar më datë 25 gusht të vitit 2021 brenda
11 një jave pas kësaj interviste u përgatiti transkripti, u
12 zbatuan redaktimet standarde dhe u nxor. Nuk pati vonesë të
13 parregullt.

14 Kjo ka dalë në bazë të rregullit 102(3), pra, nëse ZPS-ja
15 e ka materialin në bazë të këtij rregulli i nxjerr këto
16 materiale edhe sot.

17 Sa i takon Mbrojtësit të z. Haradinaj. Po të shihni
18 listën e provave materiale ka disa intervista me dëshmitarë,
19 transkriptet e tyre janë aty, që jepen në listën e provave. Ne
20 nuk i kemi parashtruar këto. Tani po presim për vendimin mbi
21 mocionin për paraqitjen e provave pa dëshmitarë për të parë
22 sesi do të veprojmë. Ajo që tha avokati nuk është se kanë
23 ndonjë mospërputhje me atë thashë unë javën që shkoi apo me
24 çfarë ka thënë ZPS-ja në janar.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjykatësit e tjerë?

1 Jo, mirë.

2 Mund të vijojmë tani me temën tjetër që ka të bëjë me
3 pikat e, pra, për faktet dhe pikat juridike për të cilat palët
4 pajtohen. ZPS-ja ka konfirmuar në një parashtrim tjetër se z.
5 Gucati, pajtohet për 13 fakte dhe z. Haradinaj pajtohet për 3
6 fakte. Nuk ka pajtim lidhur me pika juridike ende deri tani.

7 Ka ndonjë ndryshim lidhur me këtë z. Rees?

8 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk ka.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo.

11 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Halling keni ndonjë gjë
12 për të shtuar?

13 Mbase duhet shqyrtuar kjo, sepse më duket mua se me të
14 gjitha këto materiale mund të ketë diçka tjetër për të cilën
15 ju mund të pajtoheni si palë për ta shpejtuar procesin pa
16 shkelur të drejtat e askujt. Shpresoj se ky është një proces
17 në vijim e mbase do të zhvilloni diskutime të mëtejshme për
18 këtë.

19 Z. REES: [Përkthim] Mund t'ju asistoj lidhur me diçka.

20 Doli qartë nga parashtrimet e bëra gojarisht nga z. Halling
21 javën që shkoi. Diçka për të cilën ne mund të pajtohemi, në
22 dallim nga qëndrimi i mbajtur nga Gjykatësi i Procedurës
23 Paraprake, - sa ta gjej pikën e duhur. Pra, në kundërshtim me
24 interpretimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sa i takon
25 interpretimit të hakmarrjes, ZPS-ja duket se pajtohet me

1 qëndrimin e mbajtur nga Mbrojtja për pikën 4 të akuzës,
2 hakmarrja që është diçka me synim specifik kur synimi i
3 përgjithshëm nuk është i mjaftueshëm. ZPS-ja e ka shprehur
4 këtë në transkriptin - e kemi këtë në transkript në faqen 490
5 rreshti 25.

6 Pra, duket se ka një pajtim lidhur me elementin e synimit
7 dhe mund të ketë mosmarrëveshje lidhur me këtë por të paktën
8 për pikën 4 mund të kemi një pajtim.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të merremi më vonë me
10 këtë.

11 Z. Halling, është e saktë kjo sa i takon pajtimit?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk mendoj kështu, sepse, në fakt,
13 në vendimin e konfirmimit të Aktgjykimit, aty pranohet synimi
14 specifik i pikës 4, pra, është në paragrafin 136 të vendimit
15 të konfirmimit. Sigurisht, ne mund të vijojmë që të diskutojmë
16 më tej lidhur më këtë por nuk duket se ka pajtim.

17 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani ja jap fjalën z. Barthe,
18 i cili ka disa pyetje lidhur me dy elemente të cilat janë
19 diskutuar shkurtimisht.

20 Gjykatësi Barthe, fjala është për ju.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar.
22 Qëllimi i pyetjeve të mia sot është që të marr disa sqarime
23 për të kuptuar më mirë qëndrimet tuaja nëse Mbrojtja nuk është
24 e gatshme që t'u përgjigjet këtyre pyetjeve sot apo nëse do të
25 preferonte që t'u përgjigjej më vonë, Trupi Gjykses e nxit

1 Mbrojtjen që t'i mendojë për t'ju përgjigjur më pas.

2 Tani, pyetjet e para janë për ZPS-në lidhur me pikën 1 të
3 akuzave, që është vepra e pengimit të personave zyrtarë në
4 kryerjen e detyrave zyrtare, përmes ushtrimit të forcës apo
5 kërcënimit të rëndë në përputhje me nenin 15(2) të ligjit dhe
6 nenit 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

7 Pyetja që kam unë është kjo: Z. Prokuror, a po
8 argumentoni se të dy apo vetëm njëri prej të akuzuarve ka
9 përdorur personalisht forcë apo ka bërë kërcënime të rënda dhe
10 nëse po, kush nga të dy? Dhe nëse po, cilat janë këto akte
11 specifike?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
13 Kjo pyetje do të marrë përgjigje nga unë lidhur me atë që
14 thuhet në Aktakuzë.

15 ZPS-ja pretendon kërcënime të rënda sepse kjo është ajo
16 që është bërë në vendimin e konfirmimit në lidhje me të dy të
17 akuzuarit dhe mund të shihni në paragrafin 30 të Aktakuzës me
18 listën e akteve apo të sjelljes për të cilat ngrihet akuzë. Ju
19 kërkoj ndjesë edhe njëherë, po të shihni në paragrafin 26 të
20 Aktakuzës, mund të shihni një listë të sjelljes dhe janë
21 paragrafi 27 dhe 28 për një përskrim të sjelljes së të
22 akuzuarve për të cilat ngrihet akuzë, në kuadër të kësaj pike
23 të Aktakuzës.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. prokuror, sigurisht Trupi
25 Gjykues e ka lexuar Aktakuzën dhe ju falënderojmë për pjesët e

1 aktakuzës që na tregoni, po a mund të shpjegoni më me hollësi
2 përpos që të na tregoni se ku ndodhet në Aktakuzë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Me kënaqësi.

4 ZPS-ja pretendon se ajo që kanë bërë të akuzuarit është
5 që kanë shpërndarë informacion konfidencial, kanë deklaruar se
6 qëllimi i tyre për të shpërndarë këtë informacion është që të
7 pengonin procedurat dhe kanë nxitur edhe publikun që e kanë
8 pasur në zotërim apo kanë pasur qasje në këtë informacion si
9 edhe punonjës të shtypit që të shpërndajnë më tej edhe ta
10 publikojnë këtë informacion.

11 Pastaj në përmbajtjen e paketës së parë dhe të tretë, me
12 një fjalë pjesë të këtyre janë shpërndarë. Pra, sa i takon
13 pengimit specifik, po. Sa i takon pengimit specifik ne kemi
14 ngritur pretendimin në tre pjesë: Dëshmitarët janë frikësuar
15 nga ajo që kanë bërë të akuzuarit, aftësia e ZPS-së për t'i
16 hetuar dhe proceduar penalisht efektivisht këto krime u
17 rrezikua dhe burimet e ZPS-së u devijuan.

18 Në fakt, për të sqaruar këtë, njëri prej gjykatësve javën
19 që shkoi bëri një pyetje lidhur me atë se çfarë mund të
20 paraqesim ne juridikisht si të mjaftueshme për t'i vërtetuar
21 këto pika përfshirë dhe synimin. Provat tona, kanë të bëjnë me
22 synimin e drejtpërdrejtë për pikën 1, prandaj dhe përmbajtja
23 specifikohet këtu lidhur me pikat një dhe dy. Pra, këtu
24 shpjegohen të gjitha aktet e sjelljes.

25 Por, siç e thashë javën që shkoi, ka disa aspekte të

1 elementeve që kanë alternative dhe Trupi Gjykses jo medoemos
2 mund të bëjnë konstatime për të gjitha pjesët.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mund të uleni për një moment.

4 Duke qenë se z. Rees ka ngritur çështjen e kundërshtimit
5 të elementeve, të motiveve dhe të formave të përgjegjësisë do
6 t'i drejtohem mbrojtësve, do filloj me z. Rees, nëse kanë
7 kundërshtim për elementët e veprave penale dhe për format e
8 përgjegjësisë, a mund t'i thonë Trupit Gjykses se cilat
9 elemente të veprave penale dhe formave të përgjegjësisë në
10 veçanti kundërshtoni, siç janë shprehur?

11 Z. REES: [Përkthim] Rendi specifik, urdhri - më falni -
12 urdhri specifik që ka nxjerrë Trupi Gjykses në konferencën
13 përgatitore të javës që shkoi përmendet në paragrafët 33, 37
14 të Aktakuzës dhe analizën juridike që vendoset, që shprehet
15 aty dhe në vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

16 Kështu që unë do t'i marr paragrafët një për një dhe
17 mbase mënyra më e mirë për t'i dhënë përgjigje pyetjes së z.
18 Gjykatës, është nëse do t'i marr një për një paragrafët edhe
19 pse mund të hajë kohë, po do të doja që të shpjegoja mirë
20 sepse kjo mund të shprehte dhe qëndrimin tonë lidhur me
21 argumentimin tonë.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po, unë këtë po kërkoj. Cilat
23 janë kundërshtimet konkrete, jo thjeshtë argumentet në
24 veçanti.

25 Z. REES: [Përkthim] Pra, së pari ka të bëjë me shkeljen e

1 fshehtësisë së procedurës. Mua më duket se paragrafët 33 dhe
2 34 të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake janë një
3 kundërshtim, pra siç e kemi parë edhe me akuzat e ngritura në
4 kuadër të nenit 39(2) të Kodit Penal.

5 Paragrafët 35, 36 dhe 37 nuk i pranojmë. Nuk pranohen nga
6 ne. Gjykatësi i Procedurës Paraprake interpretonte nenin
7 392(1), por pa përmendur se ku mbështetej. Duket sikur aty jep
8 një interpretim të vetin i cili, sigurisht, nuk është detyrues
9 për Trupin Gjykses dhe ne do të parashtrojmë kur të vijë
10 momenti se interpretimi që ka bërë ai ka qenë tepër i
11 përgjithshëm dhe i pabazuar.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Dëshirojmë që t'ju ndërpresim
13 këtu sepse gjykatësi Mettraux ka diçka për të thënë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju
15 ndërpres, z. Rees. Procesverbali i transkriptit, faqja 13,
16 rreshti 13, thotë se ju keni thënë në lidhje me paragrafin 33
17 dhe 34 se këto paragrafë kanë qenë një kundërshtim. Mua mu duk
18 sikur thatë të kundërshtueshme, mund ta sqaroni këtë?

19 Z. REES: [Përkthim] Të pakundërshtueshme, po. Siç e
20 thashë në thelb duket se kanë -- se i referohen nenit në
21 vetvete.

22 Por paragrafët 35, 36 dhe 37 janë ato të cilat ne nuk i
23 pranojmë. Dhe e thënë shkurt, është një interpretim që
24 Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka bërë pa pasur një bazë,
25 pa përmendur se ku është bazuar, thjesht, duke dhënë vendimet

1 e veta në lidhje me këto çështje.

2 Paragrafët 39 dhe 40, për këto ne do të parashtrojmë, se
3 për te të dyja format e synimit, kryesi, sipas nenit 392(1),
4 duhet të ketë dijeni se informacioni ka qenë sekret. Dhe këtu
5 mbështetemi në një çështje kosovare në Gjykatën e Apelit të
6 Kosovës me numër MZPAKR336/16, është gjykimi i datës 13
7 dhjetor 2016.

8 Vëmë re gjithashtu se brenda analizës së nenit 392(1)
9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk thotë asgjë lidhur me
10 autorizimin. Dhe sigurisht, ky është një element thelbësor i
11 veprës penale se çdo zbulim i informacionit të bëhet pa
12 autorizim. Ne themi se Prokuroria do të duhet që të vërtetojë
13 mungesën e autorizimit dhe do të parashtrojë në momentin e
14 duhur se autorizimi, në këtë aspekt, duhet të përfshijë edhe
15 nxjerrjen në kuadër të interesit publik dhe mund të themi që
16 elementi i interesit publik është pjesë e nenit 392(1) ku
17 shikohet çështja e faktit, ka pasur apo jo autorizim.

18 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vijuar pastaj të
19 shohë edhe aspekte të tjera të nenit 392, 392(2) dhe 392(3)
20 për zbulimin e paautorizuar të identitetit apo të të dhënave
21 personale të personave të mbrojtur dhe rrethanat rënduese të
22 veprës penale kur ka pasoja të rënda për personin e mbrojtur
23 apo për procedurën penale kur këto procedura janë penguar apo
24 janë pamundësuar.

25 Gjithashtu në paragrafin 41 dhe 42 të vendimit të

1 Gjykatës së Procedurës Paraprake, mund të themi se këto dy
2 paragrafë janë të pakundërshtueshëm sepse thjesht përmendin
3 përmbajtjen e këtyre neneve.

4 Pastaj, ne nuk pranojmë paragrafët 43, 44, 45, dhe 46
5 sepse është një interpretim pa ndonjë bazë nga Gjykatësi i
6 Procedurës Paraprake.

7 Paragrafin 50 ne, në veçanti, nuk e pranojmë. Në këtë
8 paragraf, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka sugjeruar se
9 kryesit e kanë ditur ose duhet të kenë pasur arsye për të
10 ditur, pra, ai paraqet një alternativë se po zbulonte
11 identitetin apo të dhënat personale të personave të mbrojtur.

12 Edhe këtu ne parashtrojmë se në funksion të nenit 392(2)
13 dhe(3) por edhe për pikën 1, kryesit duhet të kenë ditur pra,
14 duhet të kenë pasur dijeni, ky është kushti, që po nxirrnin
15 identitetet dhe të dhënat personale. Edhe këtu, ne paraqesim
16 qëndrimin tonë se baza për këtë është vendimi i Gjykatës së
17 Apelit të Kosovës. Trupi Gjykses atëherë vërente se për të
18 shkelur identitetin apo - më falni - për të shkelur
19 identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, kryesi duhet të kishte
20 pasur dijeni për ekzistencën e urdhrit dhe për mbajtjen e tij.

21 Urdhri dhe përmbajtja e këtij urdhri, në këtë rast, që
22 mbronte identitetin dhe të dhënat personale, ishte një urdhër,
23 i cili vendoste për mbrojtjen e të dhënave. Në mungesë të
24 kësaj dijenie, kryesi në këtë rast u shpall jo fajtor.

25 Gjykatësi i Procedurës Paraprake pastaj flet për

1 hakmarrjen, veprën penale të hakmarrjes - më falni - ku
2 gjithashtu flet edhe për synimin e hakmarrjes kundër personave
3 të cilat i japin informacion policisë e të tjerë, siç vijon të
4 thotë Gjykatësi.

5 Në lidhje me paragrafin 52, Gjykatësi i Procedurës
6 Paraprake nuk përmend elementin që duhet vërtetuar, që është
7 synimi i hakmarrjes për dhënien e informacioneve të vërteta.

8 Paragrafi 53 nuk pranohet nga ne. Është një interpretim
9 që bëhet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake pa ndonjë bazë
10 apo autoritet. Ne nuk pranojmë p.sh., që dëmi duhet
11 interpretuar në bazë të nenit 388(1) se përfshin edhe
12 ndërhyrjen në mirëqenien, privatësinë apo dinjitetin, siç ka
13 sugjeruar Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

14 Përmbajtja e paragrafit 54 nuk pranohet. Gjykatësi i
15 Procedurës Paraprake edhe njëherë s'e ka kuptuar elementin e
16 rëndësishëm. Jo vetëm që kryesi duhet të ketë synimin për të
17 marrë hak për dhënien e informacionit të vërtetuar, të vërtetë
18 - më falni- por Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk
19 mbështetej aty tek elementi i rëndësishëm i informacionit që
20 jepet në këtë rast, i cili duhet të ishte i vërtetë, pra,
21 duhet të ishte i vërtetë informacioni që jepte personi kundër
22 të cilit merrej hak.

23 Paragrafët 55 dhe 57 nuk pranohen nga ne. Në këto
24 paragrafë, pavarësisht se pranohet se kishte një synim
25 specifik, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithsesi vijon të

1 thoshte se synimi i drejtpërdrejtë edhe i mundshëm do të
2 mjaftonte. Ne themi që synimi i mundshëm nuk mjafton sepse kjo
3 vepër, vepra e hakmarrjes për dhënie informacioni të vërteta
4 është specifike dhe që kërkon synim specifik në bazë të nenit
5 388(1). Ne do të kishim menduar se ZPS-ja do të pajtohej me
6 Mbrojtjen.

7 Ne kishim menduar se ZPS-ja kish rënë dakord me këtë
8 propozim duke pasur parasysh parashtrimet e z. Halling në
9 transkript i keni në faqen 490, rreshti 25, por ndoshta e kemi
10 keqkuptuar qëndrimin e ZPS-së mbase ata mund do ta sqarojnë
11 qëndrimin e tyre.

12 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ju kthye pastaj çështjes
13 së frikësimit. Neni 387 i Kodit Penal të Kosovës parashikon që
14 kushdo që përdor forcë apo kërcënim të rëndë apo ndonjë mjet
15 detyrimi apo premtimi të ndonjë dhurate për të detyruar një
16 person që të mos bëjë një deklaratë apo të japë një deklaratë
17 të rreme apo të mos thotë informacionin e vërtetë policisë,
18 prokurorit apo gjykatësit kur një informacion i tillë lidhet
19 me pengimin e proceduarve penale, dënohet.

20 Paragrafi 58 i analizës së Gjykatësit të Procedurës
21 Paraprake nuk pranohet. Neni 387 kërkon kërcënim me forcë apo
22 të rëndë apo ndonjë mjet tjetër për ta detyruar personin
23 përmes dhuratave apo përfitimeve të tjera. Do ta them, nuk do
24 ta them të gjithë, po të them vetëm forcë dhe kërcënim të
25 rëndë e tjera, për ta detyruar një person që të mos japë një

1 deklaratë, pra, kërkon, themi ne, personi nxitet, shtyhet të
2 mos japë një deklaratë apo ndryshe nuk jep informacion të
3 vërtetë që shkurtimisht do të përqendrohej vetëm ke dhënia e
4 deklaratës.

5 Pra, ne themi se, është një vepër e cila kërkon provë për
6 pasojat që personi është detyruar të mos japë një deklaratë.
7 Nuk e pranojmë propozimin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake
8 pa u referuar diku se forca apo kërcënimi drejtohet ndaj një
9 personi që jep apo që ka gjasa të japi një deklaratë. Ne këtë
10 e quajmë të pamjaftueshme.

11 Neni 387 kërkon informacion, parashikon gjithashtu që
12 duhet dhënë informacion që nuk është dhënë si rezultat i
13 forcës apo kërcënimit të rëndë, kërkon që ky informacion të
14 lidhet me pengimin e procedurave penale. Ky është një element
15 që Gjykatësi nuk e ka marrë parasysh fare në analizën e tij.

16 Paragrafi 59 nuk pranohet. Neni 387 nuk ndalon, siç thotë
17 Gjykatësi, ndonjë sjelljeje që mund të pritët të ketë ndikim
18 apo influencë në deklaratën që do të jepet nga një person
19 informacioni. Ne themi që vetëm ndalon përdorimin e forcës apo
20 kërcënimit me anë të formave të ndryshme dhuratave, premtimeve
21 dhe, siç thashë më përpara, ai kërkon që personi tjetër të
22 nxitet të mos japë një deklaratë apo ndryshe të mos japë
23 informacion të vërtetë.

24 Analiza e Gjykatësit në paragrafin 60 nuk pranohet. Dhe
25 shtoj kushtin që përkufizimi i nenit 113 i Kodit Penal përdorë

1 kodin forcës që është një term "forcë" është një term
2 gjithëpërfshirës. Pra, e përmend fjalën "forcë" për qëllimet e
3 kodit.

4 Pra, neni 113 përkufizimi fillon: "Për qëllimet e kodit
5 termat më poshtë kanë këto kuptime dhe forcë është në nenin
6 115 jepet kuptimi, mjetet për ta detyruar një person
7 përkundrejt kundër vullnetit të tij duke e bërë atë të paaftë
8 të rezistojë...".

9 Është përkufizimi që jepet në nenin 113.

10 Në qoftë se "forca", për qëllimet e nenit 387 dhe
11 pavarësisht seç thuhet në seksionin e përkufizimeve, thuhet se
12 përfshin forma të tjera të dhunës fizike megjithatë ne duam të
13 tërheqim vëmendjen tek kufizimi që kërkon që personi të sillet
14 në gjendje të paaftë, të pavetëdijshme.

15 Pra, ne parashtrojmë se vepra në nenin 387, duhet
16 interpretuar në përdorimin e forcës dhe kërcënimit të rëndë që
17 të lidhet, konkretisht, me përdorimin apo kërcënimin për
18 përdorim të forcës që do të kishte pasojat e parashikuar në
19 nenin 135.

20 PËRKTHYESJA: Gjykatësi i tërheq vëmendjen avokatit se
21 flet shpejt.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mund të na thoni sesa akoma
23 ju duhet për të mbuluar këtë temë?

24 Z. REES: [Përkthim] E njëjtë. Po aq kohë saç kam përdorur
25 deri tani. Ju më pyetët. Po, po bëj maksimumin tim që t'ju

1 ndihmoj.

2 Fakti është që nuk e pranojmë analizën që ka bërë

3 Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk dua t'ju kufizoj, thjesht
5 më shumë përqendrohuni tek qëndrimi.

6 Z. REES: [Përkthim] Paragrafi 61 nuk e kuptojmë aty se
7 çdo të thotë Gjykatësi me fjalët "dëshmitar i mundshëm".

8 Paragrafi 62 nuk pranohet. Siç thashë ndërkohë do të
9 parashtrojmë se ne do të kërkojmë prova se bëhet fjala që
10 dikush të pengohet të japi një deklaratë.

11 Gjykatësi gjithashtu ka bërë krahasim midis dy neneve 386
12 dhe 387, që një është ushtrim i dobishëm, por ai ka gabuar në
13 analizën e tij për mendimin tonë.

14 Megjithatë, ai pranoi se rregulli 386 kërkon prova të
15 pasojave. Këtë e thotë shprehimisht nën poshtë shënimin 42.
16 Ndryshe nga neni 387, 386 që flet për veprat përfshin ofrimin
17 e të dhënave, ryshfetet, kërcënimin, dhunën apo forma të tjera
18 detyrimi.

19 Pra, ka një mbivendosje midis nenit 386 dhe 387. 386
20 kërkon prova pasojash kurse 387, gjithashtu, bën të njëjtën
21 gjë. Ne vërejmë dhe Gjykatësi s'ka komentuar se dënimi
22 maksimal për nenin 386 janë më të rënda se ato në rastin e
23 nenit 387 dhe s'ka shumë kuptim që neni 386 kërkon prova të
24 pasojave kurse 87 [sipas përkthimit] jo.

25 Ne themi që tipari rëndues dallimi midis dy veprave, pra,

1 të mbuluara nga 386, 387 është se, ato të 386 duhet të ndodhin
2 në lidhje me procedura që lidhen me atë, 387 duhet të lidhen
3 me nenin 386, pra, duhet të ketë këmbëngulje për të penguar jo
4 vetëm procedurat fillestare por dhe procedurat për pengimin e
5 procedurave fillestare që përfshihen në 387.

6 Paragrafi 63, 65 "për synimin" nuk i pranojmë. Pra,
7 synimi konkret qëllimi apo dëshira e drejtpërdrejtë që
8 kërkohet është për ta detyruar një person që të mos japë një
9 deklaratë. Ne themi që kryesi mundet vetëm të ketë një synim
10 të drejtpërdrejtë në lidhje me pengimin e një personi në
11 kryerjen e detyrave zyrtare.

12 Paragrafi 67, 68 nuk pranohen, sepse lidhen me analizën
13 që bën Gjyqtari për forcën dhe kërcënimet. Mjetet në lidhje me
14 pjesët e më përparme të analizës së tij.

15 Në këtë kontekst, për mendimin tonë "kërcënim i rëndë" do
16 të thotë kërcënim i rëndë dhe forcë.

17 Gjithashtu parashtrojmë se neni 401(1) kërkon forcën apo
18 kërcënimin serioz të rëndë të drejtuar ndaj një personi
19 zyrtar. Gjyqtari nuk paraqet një qëndrim të kundërt, po nuk ka
20 autoritetin e duhur, nuk mbështetet në autoritetin e duhur.
21 Formulimi sipas tij në 401(1) nuk i referohet përdorimit të
22 forcës.

23 Por në 401(5), vepra e rënduar, fjalët konkretisht i
24 referohen kur vepra kryhet kundër një gjyqtari dhe zyrtarëve
25 të tjerë pra, po përqendrohemi te gjyqtari gjatë ushtrimit të

1 funksionit të tij zyrtar. Ne themi që kjo e bën të qartë në
2 qoftë se s'ka qenë e qartë ndërkohë nga ato që thotë 401(1),
3 se forca e kërcënimit serioz duhet të drejtohet ndaj një
4 personi në cilësinë zyrtare.

5 Paragrafi 69 dhe 70 janë shembuj të interpretimit të
6 Gjyqtarit që e ka bërë pa autoritetin e duhur.

7 Në lidhje me paragrafin 73, nuk pranohet dhe ai. Ne themi
8 se pasojat e ndaluara për qëllimet e nenit 401(1) dhe (5)
9 është pengimi apo përpjekja për të penguar kryerjen e ofiqeve
10 zyrtare të një personi me anë të forcës së rëndë. Nuk mjafton
11 që synimi të jetë synimi që i pandehuri të dijë që një personi
12 zyrtar duhet të pengohet.

13 Pra, ky pengim me anë të kësaj force apo kërcënimi serioz
14 duhet të ndodhë.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju lutem, përfundojeni brenda
16 pesë minutash këtë argumentimin tuaj.

17 Z. REES: [Përkthim] Pengimi i një personi zyrtar nuk
18 ndodh nëpërmjet mjeteve të ligjshme. Siç thotë Aktakuza, vetëm
19 synimi i drejtpërdrejtë do të mjaftonte për të shprehur
20 synimin.

21 Pastaj, Gjyqtari vazhdon te pengimi i personave zyrtarë
22 përmes pjesëmarrjes në një grup.

23 Nuk e pranojmë paragrafin 75. Parashtrajmë se veprimet e
24 përbashkëta që përmenden në 401(1) duhet t'i referohen
25 veprimeve të përbashkëta për përdorimin e forcës apo

1 kërcënimit. Thënë ndryshe, aktiviteti i përbashkët i ligjshëm,
2 siç do të ishte i penalizuar dhe kjo nuk është e drejtë.

3 Nuk e pranojmë 76 për të njëjtën arsye.

4 Në lidhje me paragrafin 70 nuk pranohet synimi i kërkuar,
5 pra, dëshira për të përdorur forcë apo kërcënim serioz nga tre
6 persona apo më shumë. Përdorimi i fjalës së përbashkët tregon
7 që qëllimi i përbashkët do të mjaftonte.

8 Në lidhje me format e përgjegjësisë për aq sa nuk e kam
9 trajtuar deri tani nuk e pranojmë paragrafin 82, ku Gjykatësi
10 i Procedurës Paraprake ka thënë se synimi eventual do të ishte
11 i mjaftueshëm për të gjitha akuzat.

12 Nuk pranojmë as 84 deri 87, bashkëkryerja e disa
13 personave do të kërkonte synimin konkret, në përkufizimin e
14 Gjyqtarit të bashkëkryerjes, kërkohet njohuria dhe dëshira për
15 të kryer një veprim të tillë.

16 Gjithashtu, ne themi, se bashkëkryesit duhet të jetë të
17 veprojnë së bashku në kryerjen e një vepre penale.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Disa nga këto çështje do të
19 mbulohen nga gjykatësi Barthe.

20 Keni gjëra të tjera?

21 Z.CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për të shtuar.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Sepse gjyqtari Barthe do të
23 bëjë disa pyetje dhe mund t'u përgjigjeni. Gjyqtari Barthe do
24 të trajtojë disa nga këto çështje.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Shkurt. Ne nuk e kemi ditur që

1 Mbrojtja do të bënte këtë prezantim të mendimeve të tyre, siç
2 bëri tani, prandaj duam që të jepet mundësia ta bëjmë këtë gjë
3 me shkrim.

4 Sugjerimi im do të ishte për ju, çfarëdo pyetje që keni
5 ju ne do të t'i përgjigjemi sot por, nëse gjyqtarët duan
6 parashtrime të tjera nga ana jonë lidhur me ato që tha
7 Mbrojtja, do ta bëjmë me shkrim. Të shikojmë se cilat pyetje
8 do të bëjë gjyqtari Barthe se janë mjaftë pyetje. Do t'ia jap
9 fjalën atij pastaj do të shohim.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.
11 Vazhdojmë akoma të merremi me akuzat në pikën një, pra,
12 pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre
13 zyrtare.

14 Pyetja ime është për ju, z. prokuror, a jeni duke thënë
15 se, të dy të akuzuarit kanë përdorur kërcënime të shprehura
16 apo të nënkuptuara?

17 A mund ta sqaroni këtë, ju lutem, për ne?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Ne themi që kërcënimet e tyre
19 përbëjnë kërcënime serioze sipas kuptimit të dispozitës,
20 përfshin sjelljen e cila ndonjëherë është hapur kërcënuese,
21 ndonjëherë është e nënkuptuar kërcënuese.

22 Pra, ne akuzojmë të dy format.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. prokuror, për t'u sqaruar, në paragrafin 97 të dosjes
25 paragjyqësore thuhet që "veprimet e të akuzuarve janë kryer me

1 anë të kërcënimeve serioze të drejtuara ndaj ZPS-së dhe
2 indirekt ndaj kërcënimeve të dëshmitarëve dhe anëtarëve të
3 stafit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, sidomos
4 të hetimit të vazhdueshëm të Prokurorisë”.

5 Sigurisht, nuk ka nevojë që të përmendni emra të ZPS-së
6 për t’ju përgjigjur këtyre pyetjeve, por a mund të na
7 shpjegoni se nëse pretendoni se ka anëtarë konkret tuaj, të
8 stafit tuaj që janë kërcënuar konkretisht nga një apo të dy të
9 akuzuarit, nëse po, cilat nga këto veprime përbëjnë kërcënime
10 të rënda ndaj stafit të ZPS-së.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kërcënimet serioze të pretenduara
12 drejtohen ndaj dëshmitarëve, sipas kuptimit të dispozitës.
13 Fakti është që ka pasur efekt në zyrën tonë. Nuk ka asnjë
14 zyrtar në zyrën tonë që të jetë penguar ndryshe nga të tjerat,
15 po pasoja e sjelljes së tyre ka penguar personat në kryerjen e
16 punëve të tyre.

17 Prandaj dhe ne nuk kemi akuzuar ndonjë person me emër po
18 kemi thënë që ka penguar personat në kryerjen e detyrave
19 zyrtare.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Pyetja tjetër, gjithashtu, është për Prokurorinë dhe ka
22 të bëjë me veprën e pengimit të personave në kryerjen e
23 detyrave të tyre zyrtare në vazhdim të asaj që thatë. Si puna
24 e Gjykatës apo e ZPS-së është prekur apo është vonuar si
25 rezultat i veprimeve të pretenduara të të akuzuarve sidomos

1 për detyra zyrtare nëse janë kryer apo jo ato?

2 Paneli është në dijeni se ju keni thënë se një nga
3 dëshmitarët tuaj do të dëshmojë në këtë drejtim, ndoshta mund
4 të na thoni, të na e përmblihdni pak a shumë qëndrimin tuaj në
5 lidhje me këtë gjë. Faleminderit.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Ju keni të drejtë që dëshmia e
7 këtij dëshmitari është për këtë gjë.

8 Mënyra sesi e ka penguar është se dëshmitarët janë
9 frikësuar dhe mundësia jonë për të hetuar efektivisht krimet
10 është penguar nga ky frikësim dhe burimet janë drejtuar për të
11 trajtuar pasojat konkrete dhe të mundshme të dëshmitarëve.

12 Pra, kjo është mënyra sesi ne themi që janë penguar në
13 bazë të pikave 1 dhe 2.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

15 Kam tre pyetje për Mbrojtjen dhe ju kërkoj paraprakisht
16 falje z. Rees, ndoshta s'i kuptova të gjitha gjërat që thatë
17 dhe mbase do të duhet t'i përsërisni disa gjëra.

18 Pra, pyetja e parë për të dy avokatët e Mbrojtjes është,
19 po filloj nga z. Rees: ju kuptova drejt që nuk pajtoheni me
20 gjetjen e Gjyqtarit në vendimin e konfirmimit në pikën 8 se
21 veprimi i pengimit nuk kërkon që forca apo kërcënimi të
22 drejtohen drejtpërdrejtë një personi zyrtar apo që forca dhe
23 kërcënimi mund të drejtohen ndaj një apo disa personave për sa
24 kohë që po citoj "ajo rezulton në pengimin apo në përpjekje
25 për të penguar personat në kryerjen e detyrave të tyre

1 zyrtare".

2 Z. Rees, sigurisht, ju e përmendët këtë gjë nuk keni
3 nevojë ta përsërisni të gjithë argumentet, po vetëm sa për ta
4 sqaruar këtë pikë.

5 Z. REES: [Përkthim] Po, nuk e pranojmë. Parashtrojmë se
6 neni 401 kërkon që "forca apo kërcënimi të drejtohen kundër
7 personit zyrtar".

8 Interpretimi i Gjykatësit është një interpretim që ai nuk
9 ka pasur autoritet ta bënte, nuk u mbështet në ndonjë burim
10 autoritativ, pra, ai thotë që neni 401(5), thotë se vepra
11 duhet kryer kundër një gjyqtari dhe personave të tjerë zyrtarë
12 e të tjera, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

13 Ne themi që forca apo kërcënimi serioz duhet të drejtohet
14 kundër personit zyrtar.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Cadman.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Qëndrimi ynë është ekzaktësisht i
18 njëjtë për të gjitha këto pika. Ne me udhëzimin tuaj do të
19 paraqesim arsyetimet tona për të gjitha gjërat që tha z. Rees.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Pyetja ime tjetër është për Mbrojtjen gjithashtu. Z.
22 Rees, nuk e mbaj mend të paktën që t'i keni prekur apo mbase
23 është pyetje e re shpresoj.

24 A mendoni që Prokuroria duhet të provojë që veprimet e të
25 akuzuarit janë drejtuar kundër kryerjes së detyrave konkrete

1 p.sh., masave konkrete hetimore siç është ekzekutimi i një
2 urdhër kërkimi apo lidhje me provat, me sekuestrimin e
3 provave?

4 Z. REES: [Përkthim] A mund të reflektoj për këtë pikë, më
5 lejoni?

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

7 Z. Cadman, keni gjë?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe ne gjithashtu do të mendojmë
9 për këtë përpara se të përgjigjemi, do të përgjigjemi pak më
10 vonë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prokuroria, doni të
12 komentoni apo edhe ju keni ndonjë qëndrim për të mbajtur për
13 këtë çështje?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po, është i ngjashëm me përgjigjet
15 e pyetjeve të tjera. Nuk ka nevojë të provohet që masa
16 konkrete hetimore janë prekur nga kjo gjë për të provuar pikën
17 1.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.

19 Pyetja e fundit që kam, për Mbrojtjen sidomos, për pikën
20 1 është kjo: A ka kërkesa të tjera ligjore që nuk parashikohen
21 shprehimisht në paragrafin -- në nenin 401 të Kodit Penal
22 lidhur me kërkesën e njëkohshmërisë së kërcënimit me veprën e
23 një personi zyrtar?

24 Dhe e kam fjalën për komentën -- komentarin për Kodin
25 Penal të botuar nga Zalihi, nga Sali Zalia dhe të tjerë, në

1 2014. Konkretisht për nenin 401.

2 Nuk pres që të keni patjetër një mendim konkret, po nëse
3 keni mund ta thoni.

4 Z. REES: [Përkthim] Dhe për këtë gjë duhet të mendohemi,
5 i nderuar Gjykatës. Duhet ta shqyrtojmë komentarin dhe pastaj
6 të shprehemi.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe ne po përfitojmë nga ky rast
8 sepse përgjigja e pyetjes suaj ka të bëjë me kuptimin e fjalës
9 "njëkohshmëri". Duhet ta studiojmë, pastaj t'ju kthejmë
10 përgjigje.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit,

12 Tani po kalojmë tek neni 401(2), (3) dhe (5)të Kodit
13 Penal të Kosovës të 2019-s që mbulon pikën (2), pra, vepra e
14 kryerjes e pengimit të kryerjes së detyrave zyrtare.

15 E di që praktika gjyqësore për këtë vepër lidhet
16 kryesisht me dhunën e përdorur nëpërmjet të cilës personi që
17 kryen pengimin nuk identifikohet dot dhe kjo është trajtuar në
18 Gjykatën e Apelit në rastin, në çështjen e 28 majit 2014,
19 PAK513/2013. Nuk ishte e mundur që të përcaktohet veprimi
20 konkret i pengimit.

21 Në këtë kontekst, dua t'ju pyes cila është marrëdhënia,
22 çfarë lidhje ka paragrafi 1 dhe 2 i nenit 401 të Kodit Penal
23 të Kosovës dhe më konkretisht, mendoni që dy paragrafët mund
24 të zbatohen njëkohësisht së bashku për këtë çështje që po
25 trajtojmë?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja e fundit është më e lehtë.
2 Po mënyra sesi e kemi akuzuar ne çështjen i kemi marrë
3 parasysh të dy.

4 Ne e dimë sesi është mbajtur qëndrimi lidhur me dhunën e
5 turmës. Në qoftë se kemi një situatë ku pengimi ndodh përmes
6 pjesëmarrjes së një grupi nëpërmjet veprimeve të përbashkëta,
7 siç thuhet në Aktakuzë edhe aty përbushen elementet e kësaj
8 vepre.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rees dhe z. Cadman, doni
10 të komentoni?

11 Z. REES: [Përkthim] Po.

12 Siç thash përpara, ne parashtrojmë se lidhja midis nenit
13 401(1) dhe 401(2) kërkon veprimin e përbashkët për të përdorur
14 forcë apo kërcënim serioz.

15 Ne themi, që një interpretim shumë më i gjerë i përdorur
16 nga Gjykatësi, nuk mund të jetë i drejtë sepse në analizën e
17 gjyqtarit ku flitet për veprimin e ligjshëm siç është
18 diskutimi në bazë të klasave do të penalizohej në këtë rast,
19 pra, këtu bëhet fjalë për veprime të përbashkëta për të
20 përdorur forcë apo kërcënim serioz dhe, ne themi, që përdorimi
21 i përbashkët e bën të qartë se grupi mund të veprojë vetëm
22 nëpërmjet një veprimi të përbashkët me një qëllim të
23 drejtpërdrejt të cilin e kanë tre apo më shumë persona.

24 Ky është parashtrimi ynë lidhur me nenin 401(2) dhe (3).

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

3 Të shkojmë te neni 387 që lidhet me pikën 3 "krijimin
4 frikësimit", që e prekëm. Nëse ky krim është krim që ka të
5 bëjë me synimin konkret apo jo, në këtë drejtim, ne jemi të
6 interesuar të dëgjojmë qëndrimin e dy palëve për arsyet, për
7 qëndrimet tuaja nëse është apo jo krim që ka të bëjë me synim
8 konkret.

9 Duam të fillojmë nga Prokuroria.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

11 Pozicioni jonë është që nuk ka një synim specifik sa i
12 takon këtij parashikimi.

13 Në qoftë se ne e krahasojmë pikën 4 që flet për synimin
14 specifik të identifikuar nga Gjykatësi Paraprak, kjo dispozitë
15 parashikon veprime të dëmshme me synimin për të krijuar
16 hakmarrje për mosdhënien e informacionit të vërtetë. Kështu
17 që, vlerësimi i Prokurorisë është që vlerësimi i Gjykatësit të
18 Procedurës Paraprake është i saktë dhe ky është pozicioni
19 jonë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit prokurorit.

21 Z. Rees.

22 Z. REES: [Përkthim] Ne mendojmë që formulimi i nenit 387
23 e bën të qartë synimin specifik. Pra, përdorimi i forcës ose i
24 kërcënimit serioz është për të shtyrë. Pra, dhe kjo kërkon si
25 rezultat një synim specifik për të kryer një vepër të caktuar.

1 Ky është pozicioni ynë lidhur me këtë çështje.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

3 Z. Cadman.

4 Ndjesë pra, pyetjet e radhës sa i takon kësaj pike i
5 drejtohet sërish Mbrojtjes. Ndoshta nuk e kapa z. Rees. A mund
6 ta përsërisni edhe njëherë, ju lutem, në qoftë se jeni dakord
7 apo jo me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në
8 atë çfarë është dhënë paragrafin 62 të vendimit për
9 konfirmimet. Pra, që sipas nenit 387, ZPS-ja nuk duhet të
10 provojë aktet e të akuzuarit kanë pasur ndikim specifik mbi
11 dëshmitarët.

12 Z. REES: [Përkthim] Neve parashtrojmë që neni 387 kërkon
13 provën dhe si rezultat është e rëndësishme që ZPS-ja të
14 provojë këtë gjë. Kjo është ajo çfarë ne mendojmë që është
15 interpretimi i nenit përkatës.

16 Analiza e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sërish, siç
17 e thashë më përpara, pa të drejtë dhe pa autoret përkatës dhe
18 analiza e bërë në krahasim në nenin 386 është pranuar, në
19 fakt, në poshtëshënimin numër 40 - ju kërkoj ndjesë - 40, pra,
20 kjo specifikohet në poshtëshënimin numër 40 që neni 386 kërkon
21 provën e pasojës. Ai nuk e ka parë nenin 386 në shumë hollësi,
22 kështu që ne parashtrojmë, se në qoftë se do të bëhet një
23 analizë e drejtë të dy veprave penale atëherë mbështetet
24 pozicioni jonë që kërkohet, gjithashtu dhe provimi i veprës që
25 parashikohet në 387.

1 Neni 386, pra, si neni 387 kërkon që përdorimi i veprës
2 penale të kryhet përmes përdorimit të forcës, kërcënimit të
3 rëndë, forma të ndryshme detyrimi, premtimet e dhuratave ose
4 forma të tjera përfitimi. Pra, me fjalë të tjera në të
5 mbulohet e njëjta sjellje, pra, sa i takon të dyjave veprave
6 penale.

7 Ne vërejmë, gjë e cila nuk është vërejtur nga Gjykatësi i
8 Procedurës Paraprake, që fakti që dënimet e parashikuara në
9 nenin 387 janë më të rënda sesa ç'parashikohet brenda
10 fushëveprimit të nenit 386 dhe sipas analizës së Gjykatësit
11 neni 386 kërkon provë-pasoje ndërkohë që neni 387 nuk kërkon
12 provë-pasoje.

13 Pra, neve mendojmë që elementët e veprave janë
14 mbivendosje dhe mendoj që tipari i cili e bën një vepër penale
15 të veçantë e që, në fakt, nuk është cekur nga Gjykatësi i
16 Procedurës Paraprake, është se procedurat në kuadër të nenit
17 387 duhet të lidhen me shtytjen e një personi që të mos japë
18 një deklaratë të caktuar, të lidhur me pengimin e procedurave
19 penale.

20 Kështu që, formulimi i nenit 387 i Kodit Penal të Kosovës
21 thotë që "përdorimi i forcës, kërcënimit të rëndë ose
22 përfitimeve të ndryshme, përfshirë këtu dhe dhuratat e tjera,
23 në mënyrë që dikush të mos japë një deklaratë apo që të bëjë
24 një deklaratë të rreme apo të mos i japë informacion të
25 vërtetë një prokurori, polici apo gjykatësi kur ky informacion

1 lidhet me pengimin e procedurave penale është i dënueshëm”.

2 Pra, pengesa procedurave penale është pjesë e nenit 386.

3 Ndërkohë që në nenin 37 kemi elementin agravues, pra, sipas
4 nesh kjo procedurë, lidhet me pengimin e procedurës që
5 parashikohet në nenin pararendës dhe sipas nesh të dyja këto
6 vepra kërkojnë provë të pasojës. Dhe neni 386 kërkon provë-
7 pasojë të një personi që nuk jep një deklaratë si rezultat i
8 parashikimit që bëhet në nenin tjetër.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

10 Ndonjë gjë tjetër, z. Cadman? ZPS-ja? Z. Cadman ju i pari.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar,
12 vetëm thjesht më lejoni të them që kjo është një çështje për
13 të cilën unë dhe z. Rees kemi diskutuar në detaje. Prova e
14 pasojës është e domosdoshme siç e shpjegoj edhe z. Rees me të
15 drejtë në parashtrimin e tij. Vetë dënimi i ndryshëm në këto
16 dispozita tregon që është e nevojshme që të bëhet vërtetimi i
17 pasojës.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] ZPS-ja.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk është se duhet të
20 interpretohet në këtë mënyrë, interpretimi në dy dispozitat e
21 ndryshme mund të justifikohet nga fakti që neni 387 përfshin
22 forcën ose kërcënimet e rënda përmes shtrëngimit. Ndërkohë që
23 neni 386 nuk parashikon të njëjtën gjë.

24 Pra, Mbrojtja e pra, thjesht po lexon formulimin e këtyre
25 neneve në mënyrë që të mund të humbë vëmendjen sa i takon

1 rrethanave. Ndërkohë neni 386 merr parasysh faktin e
2 shkaktimit të një rezultati të caktuar dhe ky është një
3 interpretim i rëndësishëm. Pra, neni 386 përfshin pasojat
4 brenda saj dhe në qoftë se kjo nuk do të ishte rasti, atëherë
5 do të thotë, ndoshta do të kishim të bënim ekzatësisht me të
6 njëjtin nen.

7 Pra, është e rëndësishme që sjellja të jetë e mjaftueshme
8 dhe ndërkohë ajo është e mjaftueshme nën parashikimin e nenit
9 387 ndërkohë që një parashikim i tillë nuk mund ose një
10 interpretim i tillë nuk mund të bëhet sa i takon nenit 386.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëhere kalojmë tek pika
12 katër.

13 Hakmarrja. Më duhet të them që e vetmja pyetje që unë kam
14 të bëjë sa i takon kësaj pike të Aktakuzës, është një pyetje e
15 cila i drejtohet Mbrojtjes dhe është një pyetje që thjesht
16 shërben për të qartësuar pozicionin tuaj.

17 Z. Rees, kam përshtypje që këtë çështje e cekët, juve e
18 cekët? A e kam të drejtë që ZPS-ja do të duhet që të provojë
19 që personi në fjalë duhet të japë informacion të vërtetë? Apo
20 thoni juve që vërtetësia e informacionit është pjesë e *actus*
21 *reus* apo *mens rea* të veprës 388 të kodit përkatës kosovar?

22 Z. REES: [Përkthim] Të dyja.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kështu mendova dhe unë.

24 Z. Cadman ndonjë gjë për të thënë?

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. prokuror.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Mënyra sesi parashikohet kjo
3 dispozitë është e tillë që kemi të bëjmë me një dispozitë
4 subjektive.

5 Ne e dimë që në vendimin e konfirmuar kjo diskutohet si
6 pjesë e elementeve objektivë të veprës, megjithatë dispozita
7 thotë që duhet që të ekzistojë synimi për sa i takon kryerjes
8 së veprës penale.

9 Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton me të drejtë
10 elementët dhe në qoftë se do të lexohej vendimi, është e qartë
11 që është bërë vlerësimi i vërtetësisë së informacionit në këtë
12 vendim dhe neve mendojmë që ky vlerësim është në pajtim me
13 interpretimin e nenit 388 të Kodit Penal të Kosovës.

14 Ky, sipas mendimit tonë, është një element *mens rea* dhe
15 është objekt i një veprimi të dëmshëm.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit për qartësimin.

17 Pyetja tjetër ka të bëjë me shkeljen e fshehtësisë së
18 procedurës përmes nxjerrjes së autorizuar të informacionit
19 sekret. Pra, kemi të bëjmë me nenin 392(1) të Kodit Penal të
20 Kosovës.

21 Z. Rees, ju kërkoj dhe një herë ndjesë, se mbase e thatë
22 dhe unë nuk e kam kapur, por thjeshtë për qëllim qartësimi, ju
23 lutem, a mund të më thoni se ju nuk jeni dakord që
24 informacioni i mbrojtur në kuptimin e nenit 392(1) përfshin
25 dhe unë citoj: "Çdo informacion që ka të bëjë me hetimet e

1 ZPS-së, përfshirë këtu bashkëpunimin me subjektet e tjera
2 ashtu siç edhe dokumentet të cilat janë shënuar si
3 konfidenciale ose të brendshme", siç është deklaruar nga
4 Gjykatësi i Procedurës Paraprake në paragrafin 37 të vendimit
5 të konfirmimit.

6 Fjala për ju z. Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk e pranoj këtë. Formulimi i
8 nenit 392(1) është specifik. Ky formulim i referohet
9 informacionit i cili nxirret në procedurat zyrtare të cilat
10 nuk duhet të nxirren sipas ligjit ose që janë deklaruar si
11 sekrete përmes një vendimi të Gjykatës ose të një autoriteti
12 tjetër përgjegjës.

13 Kështu që, fusha e veprimit të këtyre fjalëve, e këtij
14 formulimi, mënyra sesi e lexoj unë vendimin e Gjykatësit të
15 Procedurës Paraprake, është çështje e interpretimit të tij,
16 interpretimit vetjak. Ai ka aplikuar një interpretim të gjerë
17 dhe këtë gjë e ka bërë pa ndonjë të drejtë që i jepej atij.
18 Kështu që, ne mendojmë, që në asnjë rrethanë ju nuk duhet të
19 merrni parasysh këtë formulim. Neve ju ftojmë që ju të bëni
20 interpretimin e ngushtë sepse kjo është në përputhje me atë
21 çfarë kërkohet sipas Kodit Penal të Kosovës dhe Trupi Gjykses
22 do të duhet të përcaktojë për vete fushën e veprimit të
23 formulimit që sapo u citua.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

25 Z. Cadman, fjala për ju.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam gjë për të thënë,

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prokurori.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. Unë mund të
4 lexoj të njëjtin formulim dhe mund të theksoj togfjalëshin
5 "sipas ligjit".

6 Ndërkohë Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka dhënë një
7 përshkrim të detajuar lidhur me ligjin e zbatueshëm në
8 paragrafin i cili u citua prej jush dhe pozicioni ynë është në
9 një linjë me pozicionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Tani kalojmë tek një çështje tjetër, tek pika e gjashtë
12 që ka të bëjë me shkeljen e fshehtësisë së procedurës përmes
13 nxjerrjes së identitetit apo të të dhënave personale të
14 dëshmitarëve të mbrojtur.

15 Pyetja është kjo: Neni 392(2) i Kodit Penal të Kosovës, i
16 cili parashikon, "që pa autorizim, në qoftë se jepet
17 informacioni për identitetin ose të dhënat personale të një
18 personi nën mbrojtje, në një procedurë penale ose në ndonjë
19 program të posaçëm mbrojtjeje është i dënueshëm me burgim deri
20 në tre vjet" dhe po ashtu në këtë pikë, pra, i referohemi edhe
21 palëve të treta të ZPS-së.

22 Dhe këtu e kam fjalën specifikisht për paragrafin 44 të
23 vendimit të konfirmimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

24 Z. prokuror fjala për ju.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po, përgjigja është po. Në

1 paragrafin 44 përcaktohen kërkesat në vendimin për
2 konfirmimin. Dhe neve flasim për dëshmitarët e mbrojtur në
3 pikën 6 e cila do të duhet që të lexohet në bashkëlidhje me
4 përkufizimin e dëshmitarëve që jepen në Aktakuzë, siç
5 diskutohet edhe në raste të tjera të mëparshme.

6 Pra, të gjithë personat të cilët janë pjesë e këtij
7 paragrafi dhe janë pjesë e përkufizimit të dëshmitarit janë
8 pjesë e kësaj pike të Aktakuzës, pra, bien nën fushëveprimin e
9 kësaj pike të Aktakuzës.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Rees, ndonjë gjë?

12 Z. REES: [Përkthim] Pozicioni ynë i përgjithshëm është që
13 Trupi Gjykes do të duhet që ta shikojnë nga e parë këtë pikë
14 sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën një interpretim të
15 gjerë pa pasur të drejtë për ta bërë këtë gjë. Neve, ju
16 kërkojmë juve, Trupit Gjykes pra, që të shikoni dhe njëherë
17 për veten tuaj këtë pikë dhe do t'ju këshillojmë që të bënit
18 një interpretim të ngushtë që është në përputhje me
19 parashikimet e Kodit Penal të Kosovës.

20 Ndërkohë që ka edhe aspekte të tjerë të analizë që ka të
21 bëjë me nxjerrjen e paautorizuar të të dhënave personale ose
22 personave të mbrojtur, një çështje e cila është shqetësuese
23 për ne. Edhe siç e thashë, ne parashtrojmë që kryesi duhet të
24 dinte që informacioni i personave ose identiteti të ishte i
25 mbrojtur dhe duhet të ishte në dijeni të urdhrave që mbronin

1 dëshmitarët dhe përmbajtjes së tyre.

2 Po ashtu ne vërejmë, se nuk ka analizë në vendimin e
3 Gjykatësit të Procedurës Paraprake sa i takon autorizimit dhe
4 mungesës apo mungesës së tij sa i takon qëllimeve të kësaj
5 vepre penale. Dhe sipas nesh ky element është shumë i
6 rëndësishëm sa i takon kësaj pike të Aktakuzës.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Cadman ndonjë gjë tjetër
8 për të thënë?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Pra, thjesht do të doja të theksoja
10 dhe njëherë dhe të mbështetja pozicionin e kolegut tim. Pra,
11 siç u tha nga z. Rees, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka
12 bërë një interpretim goxha të gjerë, kështu që, do të donim që
13 ta ftonim Trupin Gjykses që ta shqyrtonte nga e para këtë
14 çështje. Kështu që, ne do t'ju japim parashtrimet me shkrim në
15 mënyrë që edhe të kursejmë pak kohë.

16 Z. REES: [Përkthim] Kemi dhe një çështje tjetër përpara
17 sesa të kalojmë në një tjetër diskutim.

18 Formulimi i nenit 392(3), pra vepra penale, pra, thuhet
19 që procedura penale bëhet e pamundur ose pengohet rëndë dhe me
20 fjalë të tjera kjo është një barrë e cila është anashkaluar
21 nga Gjykatësi Paraprak, sa i takon pasojës dhe sa i takon
22 vlerësimit për këtë pikë të Aktakuzës. Do të donim t'ju
23 sillnim në vëmendje dhe këtë gjë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëhere, këto ishin
25 elementët e mi sa i takon elementëve të krimit, domethënë,

1 këto ishin komente që i kisha për të dhënë. Nuk e di në qoftë
2 se kolegët e mi do të duan që të vazhdojmë më tej apo në qoftë
3 se mund të vijojmë me pikën e radhës që janë format e
4 përgjegjësisë.

5 Pyetja tjetër ka të bëjë me format e përgjegjësisë. Është
6 një pyetje shumë e përgjithshme. Është një pyetje e cila i
7 drejtohet të gjitha palëve. Pyetja është kjo: Cila është
8 marrëdhënia midis mënyrave, formave të ndryshme të
9 përgjegjësisë penale, në veçanti, marrëdhënia ndërmjet nxitjes
10 dhe bashkëkryerjes?

11 Së pari Prokuroria është fjala për ju.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Marrëdhënia ndërmjet formave të
13 përgjegjësisë së akuzuara jepen qartë në paragrafin 44 të
14 Aktakuzës. Pra, ne kemi të bëjmë me forma alternative të
15 përgjegjësisë penale të cilat lidhen me pikat e Aktakuzës.

16 Siç përcaktohet në vendimin e konfirmimit, elementët e
17 këtyre formave të përgjegjësisë janë të ndryshëm, në veçanti,
18 shihet që nxitja ka variacione në Kodin Penal të Kosovës të
19 cilat nuk aplikohen për bashkëkryerjen. Kështu që, ka dallime
20 që parashtrohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe nga
21 ne, sepse këto procedura, pra, duhet të shikohen veçmas edhe
22 pse ato janë të parashtruara ndryshe dhe veçmas edhe në
23 Aktakuzë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rees.

25 Z. REES: [Përkthim] Sigurisht që Aktakuza është çështje

1 për Prokurorinë edhe neve, në fakt, e kemi vrarë mendjen se
2 cila është marrëdhënia ndërmjet formave të përgjegjësisë
3 penale që pretendohen, pra, i vetmi përfundim që ne mund të
4 nxjerrim është që Prokuroria ka dhënë të gjitha alternativat
5 që kishte në dispozicion kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj.

6 Ne do të reflektojmë më tej lidhur me këtë çështje,
7 megjithatë për pjesën time, për këtë pikë do të doja të thosha
8 ky është një tjetër element që e bën të qartë që është e
9 vështirë që të kuptohet pozicioni i Prokurorisë lidhur me
10 këtë. Faleminderit.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetjet e radhës kanë të
12 bëjnë me ZPS-në. Janë pyetje që kanë të bëjnë me nxitjen në
13 pajtim me nenin 42, paragrafi 2 të Kodit penal të Kosovës.
14 Pyetja për ju është kjo: Cilat janë veprat specifike penale të
15 cilat kanë mbetur në tentativë po që nuk janë kryer nga të
16 akuzuarit dhe/ose anëtarë të medias apo dhe/ose nga persona të
17 tjerë?

18 Fjala është për ju z. prokuror.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar. Siç e
20 specifikove, këto deklarohen si forma specifike përgjegjësie
21 lidhur me atë çfarë neni 42(2) parashikon si vepra penale.
22 Këtu kemi të bëjmë me pika të cilat specifikohen në nenin 47,
23 paragrafi 5 i Aktpadisë që ka të bëjë me nxitjen e kryerjes së
24 krimeve për pengimin e personave zyrtarë për kryerjen e
25 detyrave zyrtare.

1 Domethënë, sjellja e pretenduar është e njëjta. Varet
2 sesi Trupi Gjykses i përcakton faktet në këtë çështje sepse
3 alternativa të ndryshme mund të përdoren dhe alternativa të
4 caktuar mund të mos jenë të disponueshme. Ne e kemi përcaktuar
5 fushëveprimin e përgjegjësisë, e formave të përgjegjësisë
6 penale nga të akuzuarit, gjë e cila është e konfirmuar. Kështu
7 që pozicioni ynë është ky.

8 Kur unë flas për forma alternative të përgjegjësisë
9 penale, kjo është një mënyrë, pra, kjo është një çështje të
10 cilën neve parashikojmë që t'jua parashikojmë dhe t'jua
11 shpjegojmë me shkrim në kohë më të vonë, jo tani për momentin.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.

13 Nuk e di Mbrojtja në qoftë se ka ndonjë gjë? Jo, mirë,
14 faleminderit.

15 Tani vijojmë me pyetjen e radhës. Është pyetje që i
16 drejtohet sërish prokurorit.

17 Z. prokuror, vërej se neni 32 për nxitjen, pra, neni 32
18 paragrafi 3 i Kodit Penal, i cili parashikon që çdokush i cili
19 në mënyrë të qëllimshme nxit një person tjetër për të kryer
20 një vepër penale, do të dënohet për tentativën. Atëherë duke
21 parasysh që asnjë prej krimeve për të cilat akuzohen të
22 akuzuarit dhe asnjëra prej tyre nuk janë të dënueshme deri në
23 5 vjet, gjë e cila është e nevojshme, mbi bazën e nenit që unë
24 sapo citova, a mendoni që tentativa e tyre për të kryer një
25 vepër të tillë është e dënueshme?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Neve mendojmë që gama e dënimit që
2 parashikohet në nenin 32(3) është e indeksuar tek dënimi që
3 parashikohet për vepra të tjera. Pra, ne mendojmë që kjo
4 dispozitë lejon ngritjen dhe akuzimin me veprën penale. Dhe
5 nuk jemi vetëm ne që e kuptojmë kështu, por edhe Gjykatësi i
6 Procedurës Paraprake e ka kuptuar në të njëjtën mënyrë këtë
7 element.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në qoftë se do të shikojmë
9 nenin 28(2) të Kodit Penal në Kosovë, formulimi është që
10 dënimi mund të vendoset, kështu që, do të doja që t'ju kërkoja
11 në qoftë se shikoni ndonjë dallim ndërmjet këtyre dy
12 dispozitave. Domethënë, neni 32(3) dhe nenit 28(2). Domethënë,
13 shikoni ndonjë dallim sa i takon formulimit të këtyre dy
14 neneve?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se po i
16 përgjigjem pyetjes, megjithatë, ka një dallim sa i takon
17 akuzimit të të akuzuarve nën këto dy dispozita të ndryshme.
18 Pra, në njërin prej neneve parashikohet dënimi në më pak sesa
19 tre vite. Nuk është pozita jonë pozicioni jonë që këto
20 dispozita po japin një interpretim që bie ndesh me
21 interpretimin që unë sapo ju thashë. Por kemi të bëjmë me
22 dënime të cilat janë të ndryshme dhe kjo është arsyeja sepse
23 ne kemi përdorur këto dy nene si bazë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. prokuror.
25 Ndonjë gjë tjetër? Z. Rees?

1 Z. REES: [Përkthim] Po, është pikë goxha e volitshëm jemi
2 të lumtur që ta mbështesim atë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë faleminderit
4 Mbrojtja, faleminderit Prokuroria, këto ishin pyetjet e mia.

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Atëherë pranojmë marrjen e
6 parashtrimit të Mbrojtjes sa i takon përkufizimit të interesit
7 publik, bazës ligjore të mbështetur, për sa i takon kryerjen e
8 veprës penale, jurisprudencës të legjislacionit. Paneli ju
9 është mirënjohës për parashtrime tuaja lidhur me këto pika.

10 Tani do të bëjmë një pushim deri në orën 11.30 edhe do të
11 doja t'ju falënderoja për përgatitjen për këto çështje të
12 komplikuar ligjore. Pra, ishte një diskutim goxha i dobishëm
13 për ne dhe shpresoj të ketë qenë i dobishëm edhe për juve.

14 Atëherë do të bëjmë një pushim dhe do të fillojmë sërish
15 në orën 11.30.

16 --- Pauza fillon në orën 10.55

17 --- Seanca rifillon në orën 11.30

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Dua që të them diçka. Trupi
19 Gjykues ka vënë re se disa prej parashtrimeve të protokolluara
20 të ZPS-së përmbajnë parashtrime materiale në poshtëshënime,
21 poshtë faqes. I kujtoj të gjitha palët se çdo çështje
22 materiale duhet të trajtohet në tekstin e parashtrimit të
23 protokolluar dhe jo në shënimet poshtë faqes, në mënyrë që të
24 mos na shpëtojë ndonjë pjesë materiali.

25 Tani ja jap fjalën gjykatësit Mettraux.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
2 gjykatës Smith.

3 Fillimisht do ja jap fjalën Mbrojtjes, të cilës ju dha
4 urdhër për t'ju përgjigjur kërkesës së ZPS-së për të shtuar
5 një dëshmitar në listën e tanishme. Dëshëm t'ju japim
6 mundësinë që të t'i përgjigjeni kësaj gjëje gojarisht tani.

7 Në fillim zoti Rees, pastaj zoti Cadman.

8 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

9 Në këtë moment unë kërkoj asistencë të mëtejshme nga
10 Prokurori i Specializuar lidhur me natyrën e dëshmisë së këtij
11 dëshmitari. Këtu dua të mbështetem tek ajo në të cilën u
12 mbështet edhe gjykatësi Barthe, tek ajo pjesë e aktakuzës e
13 cila pretendon kryerjen e krimeve nga të tjerët nën
14 inkurajim, siç pretendohet, të zotit Gucati dhe të
15 bashkakuzuarit tjetër.

16 Paragrafi 47, pika 4, pra paragrafi 47 i aktakuzës, pika
17 4, siç e ka përmendur edhe zoti Halling sot, pretendon në
18 mënyrë specifike se të akuzuarit nxitën dhe ndihmuan në
19 kryerjen e veprave penale të pengimit të personave zyrtar në
20 kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës
21 penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës.

22 Lidhur me [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të 08/09/2021*
23 të paktën unë nuk mendoj se [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të*
24 *08/09/2021*.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Përpara se të vijojmë, ju lutemi
25 se parashtrimi i protokolluar lidhur me këta dëshmitarë ka

1 qenë konfidencial dhe kemi kërkuar redaktime sa i takon emrit
2 të punonjësit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari 04866.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Një moment. Mos duhet që ta
5 korrigjojmë transkriptimin për ta fshirë emrin?

6 Vijoni, zoti Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] Mos vallë kemi nevojë të kalojmë në
8 seancë private? Sepse do më duhet ta përmend materialet që
9 janë në nxjerrje, në paketat e nxjerrjes.

10 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Vetëm emri është ai që doni
11 të mbroni?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Dhe emrin mund ta mbani
14 parasysh.

15 Z. REES: [Përkthim] Dua që të bëj një koment. Ne e dimë
16 që së pari nuk ka një kërkesë për masa mbrojtëse lidhur me
17 këtë dëshmitar. Dhe në fakt dokumenti që na është nxjerrë
18 përmend shënimet e ZPS-së dhe në shënimin përkatës dëshmitari
19 e thotë qartë që nuk ka kundërshtim që emri t'i dalë në
20 publik.

21 Megjithatë --

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Prokurori dëshiron që të
23 përgjigjet.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Lidhur me këtë, zoti Rees ka të
25 drejtë që ne nuk po kërkojmë masa mbrojtëse për këtë

1 dëshmitar, nëse shtohet në listën e dëshmitarëve. Qëndrimi ynë
2 është se kjo tërheq vëmendje të panevojshme për këtë deri sa
3 të miratohet kjo kërkesë. Pra, aktualisht jemi vetëm në nivel
4 konfidencial lidhur me emrin, thjesht do të donim të mos
5 diskutoja asgjë që e identifikon në seancë të hapur. Të tjerët
6 pastaj mund të thuhën dhe nuk është kundërshtim në nivelin e
7 klasifikimit.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë duke përdorur
9 pseudonimin.

10 Z. REES: [Përkthim] Dëshmitari përmend atë për të cilat
11 është përgjegjës. Janë artikuj që janë të hapur, janë në
12 internet. Gjatë këtyre artikujve, ai përmend ndër të tjera
13 bashkëpunimin midis Task Forcës Hetimore dhe autoriteteve
14 serbe për të mbledhur prova lidhur me krimet e kryera gjatë
15 luftës, të cilët po hetohen tani nga Gjykata Speciale.
16 Dokumentet tregojnë qartë se si Task Forca ka bashkëpunuar me
17 autoritete serbe, ka përmbajtur korrespondencë dhe ka
18 shkëmbyer letra. Sistemi i përdorur këtu është më së shumti
19 përmes kërkesave për të mbledhur prova përmes ish -- lidhur me
20 çështjet gjyqësore dhe krimet e pretenduara. Dosjet përmbajnë
21 numra të dëshmitarëve, shumica serbë, por edhe shqiptarë romë
22 dhe ashkali.

23 Në artikullin nuk i përmend emrat por përmend mënyrën se
24 si kanë bashkëpunuar me Task Forcën dhe autoritetet serbe, si
25 bashkëpunimi midis Task Forcës dhe autoriteteve serbe ka

1 funksionar. Nga korrespondenca e këtyre letrave mësojmë se
2 është luajtur një rol kyç nga të gjitha strukturat serbe.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti Reese, deri tani kërkesa
4 që kemi përpara është një kërkesë vetëm e vetëm për leje për
5 të shtuar një dëshmitar dhe një sërë provash të lidhura me
6 listën e ZPS-së. Do ju lutesha to fokusoheshit te kjo çështje,
7 dhe të linit mënjane thelbin apo themelin e çështjes për një
8 moment të mëvonshëm. Faleminderit.

9 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë i fokusoj
10 parashtrimet e mia. Ajo që na thotë ZPS-ja -- a mos po
11 pretendojmë se [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të*
08/09/2021 është një prej këtyre personave,
12 të cilët kanë kryer vepra penale, të cilat na thuhet ne se i
13 kemi inkurajuar? Kjo është një çështje me rëndësi të cilën
14 duhet ta shohim përpara se të them nëse jam dakord apo jo me
15 shtimin e këtij dëshmitari në listën e dëshmitarëve të ZPS-së.

16 Unë po e përmendja këtë artikull sepse Trupi Gjykses do
17 ta ketë vënë re se aty ka material të cilin unë e lexova, për
18 të cilin ngrihen pretendime edhe në aktakuzë, sidomos në
19 lidhje me zotin Gucati dhe Haradinaj. ZPS-ja ka bërë ankesa
20 lidhur me këtë. Artikulli vijon duke përmendur Vladimir
21 Vuksheviçin, ish-kryeprokurorin për krimet e luftës dhe
22 Milovar Vrençin. Edhe këta janë emra të cilët janë përmendur
23 në konferencën e parë për shtyp, gjë që është kritikuar nga
24 ZPS-ja që përbën edhe bazën e provave të ZPS-së kundër këtyre
25 të akuzuarve.

1 ZPS-ja -- dhe kjo lidhet edhe me pyetjen e bërë nga Trupi
2 Gjykues më herët sot paradite, ZPS-ja a pretendon se
3 [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të 08/09/2021* është një prej
4 atyre individëve jo të përmendur me emër? Kërkoj ndjesë.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon emrit edhe lidhur me
6 atë që po lexonte avokati që nuk janë në burim të hapur, ne
7 kërkojmë redaktime nga transkripti publik.

8 Z. REES: [Përkthim] Lidhur me këtë, së pari ju kërkoj
9 ndjesë që kam përmendur dëshmitarin me emër. Për sa i takon
10 emrave të tjerë, javën që shkoi ZPS-ja e bëri shumë të qartë
11 qëndrimin e vet për materialet në burim të hapur që janë në
12 publik. Zoti Halling tha shumë qartë se nuk do kërkojë
13 redaktim për informacione që gjenden në publik.

14 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Keni përgjigje, zoti
15 prokuror?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ajo që identifikojmë këtu
17 është një gazetar dhe ai po lexon nga përmbajtja e një
18 artikulli emrat që përmend zoti Rees mund t'i trajtojmë në një
19 kontekst tjetër, por korniza që ka përmendur tani është ajo që
20 ai identifikon këtë person.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Rees, edhe njëherë ju
22 lutem të fokusoheni. E kuptojmë natyrën bazë të parashtrimeve
23 tuaja. Unë nuk mendoj se na ndihmoni nëse lexoni materialin që
24 ne e kemi apo nëse përmendni me emrin individë të tjerë për
25 arsyet që ju janë shpjeguar. Do ju lutesha edhe një herë, ju

1 lutem fokusoni parashtrimet tuaja te themeli. Por përpara
2 kësaj i lutem prokurorisë të sqarojë nëse në përgjigje të
3 ftesës suaj, kjo është pjesë e provave që dëshmitari i
4 propozuar është një prej personave që është inkurajuar.

5 Zoti Halling?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. Përmbledhja e shtojcës së
7 këtij parashtrimi e përmend aktakuzën -- se siakt akuza -
8 Paragrafi përkatës, pra 47(4) që përmendet nga Mbrojtja,
9 nuk është në atë listë. Kjo është ajo që themi ne.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kam kuptuar qartë
11 zotin Rees, është jo se ka pasur indikacion se dëshmitari juaj
12 ka kryer apo jo vepër, por nëse ka qenë apo jo pjesë e provave
13 tuaja se ai është inkurajuar nga sjellja, të cilën ju ia
14 ngarkoni njërit apo të dy të akuzuarve. Kjo është ajo që po
15 përpiqemi të kuptojmë në parashtrimet tuaja.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Do të sqarojmë.

17 Ne parashtrojmë se ky person është inkurajuar nga sjellja
18 e të akuzuarve, por siç e thatë ju saktë ne nuk po pretendojmë
19 se është kryer ndonjë krim.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti Rees, ju e morët
21 përgjigjen, tani mund të vijoni me qëndrimin tuaj për
22 kërkesën. Faleminderit.

23 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit për këtë sqarim. Për
24 sqarimin se nuk ka pasur asgjë kriminale në nxjerrjen e
25 informacionit të përshkruar në provat materiale lidhur me

1 [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të 08/09/2021*. Tani që u
2 sqarova, ju falënderoj dhe nuk kam kundërshtim që ai të
3 shtohet në listën e dëshmitarëve.

4 [Trupi Gjykses këshillohet me Administratën e Gjykatës]

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Për procesverbalin, kam
6 miratuar redaktimin e transkriptit në dy rastet e përmendura.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka edhe dy pyetje të
8 tjera, zoti Halling dhe me shumë gjasë ju i jemi përgjigjur
9 shumicës së tyre më herët sot në parashtrimet tuaja. A ta
10 kuptojmë se shënimi zyrtar në lidhje me dëshmitarin tuaj që
11 është në poshtëshënimin 9 të kërkesës suaj i është nxjerrë
12 Mbrojtjes? Kështu është?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Meqenëse e mora fjalën dua të
14 përmend, që të mos ketë ndonjë keqkuptim nga Mbrojtja e zotit
15 Gucati. Ne po pretendojmë që kjo është provë fajësuese në këtë
16 çështje. Dua të eliminoj çdo keqkuptim, se çfarë parashtrojmë
17 ose çfarë nuk parashtrojmë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të paktën siç e kuptova
19 unë, e kuptova se zoti Rees e formuloi kështu parashtrimin e
20 tij që ai sugjeron, siç e kuptoj unë, që ka një mospërputhje
21 me qëndrimin që mbani ju lidhur me atë që ka bërë dëshmitari
22 dhe atë që pretendoni se kanë bërë të akuzuarit. Por le t'i
23 drejtohem këtij problemi më përpara.

24 Z. REES: [Përkthim] Nuk është se ka ndonjë mospërputhje
25 në lidhje me atë që ka sqaruar zoti Halling, që ata nuk

1 pretendojnë se [REDAKTUAR] *Sipas Urdhrit Gojor të*
2 *08/09/2021* ka kryer ndonjë vepër penale me publikimin e
3 aspekteve që përmbajnë provat materiale. Ai e sqaroi këtë dhe
4 unë e falënderoj.

5 Unë në këto kushte nuk jam kundër që ai të shtohet si
6 dëshmitar.

7 Ka një aspekt të kërkesës të cilën unë e kundërshtoj. Ka
8 lidhje me provat materiale. Sugjerohet që intervista e
9 dëshmitarit të shtohet në provën e listave materiale. Nuk e
10 kuptoj me ç'qëllim bëhet kjo kur prokuroria kërkon që ta
11 thërrasë këtë dëshmitar që të japë dëshmi gojarisht këtu në
12 sallë. Nuk e kuptoj pse duhet shtuar edhe intervista që ai ka
13 dhënë në listën e provave materiale, duke pasur parasysh që
14 ato janë dëshmi në sallë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

16 Zoti Rees, edhe njëherë ju lutem që të mbani parasysh
17 përdorimin e emrave.

18 Por dua të pyes edhe zotin Cadman nëse mban të njëjtin
19 qëndrim si mbrojtja e zotit Gucati, se nuk kanë kundërshtim
20 për shtimin e dëshmitarit të propozuar në listën e
21 dëshmitarëve të prokurorisë. Duhet ta kisha bërë më përpara,
22 këtë pyetje, ju kërkoj ndjesë zoti Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne e kemi
24 diskutuar sa i takon marrjes së këtij sqarimi. Tani që është
25 bërë sqarimi ne e mbështesim qëndrimin e zotit Rees. Nuk jemi
kundër.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për këtë.

2 Zoti Halling, për të sqaruar diçka tjetër, më duket se
3 zoti Rees ka bërë të njëjtin gabim si dhe unë sa i takon datës
4 së intervistës. Dua edhe një herë të konfirmoni që data e
5 intervistës së dëshmitarit të propozuar është në të vërtetë
6 data 25 gusht 2021 dhe jo 25 mars 2021, siç është shkruar në
7 pjesën e sipërme të dokumentacionit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Keni të drejtë, i nderuar
9 Gjykatës.

10 Duke pasur parasysh këtë do të dorëzojmë një transkript
11 të korrigjuar të kësaj.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

13 Dy çështje të tjera që unë mendoj që i keni bërë të
14 qarta. Nuk keni ndërmend që të kërkon masa mbrojtëse për
15 këtë. Kështu?

16 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë i nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dje në fund për nga radha
18 por jo nga rëndësia, e kam kuptuar qartë që ju keni bërë një
19 shqyrtim të dokumentacionit tuaj për të siguruar që çdo
20 material në lidhje me këtë individ të veçantë, nëse miratohet
21 kërkesa, i është nxjerrë Mbrojtjes?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, çdo gjë që
23 ne kemi dijeni që ka lidhje me këtë dëshmitar.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

25 Shikoj që zoti Cadman do të marrë fjalën.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Kjo pyetje që ju trajtuat tani, ne
2 presim që ZPS-ja të bëjë një kërkim et duhur sa i takon
3 marrëdhënieve të mëparshme me këtë dëshmitar. Kjo ishte edhe
4 pyetja ime: a është kjo hera e parë që ky dëshmitar është
5 kontaktuar apo me të cilin ka biseduar ZPS-ja?

6 Se nga materiali që na është nxjerrë, duket se ka pasur
7 edhe kontakte të mëparshme me këtë dëshmitar. Ne kemi të
8 drejtë të dimë se çfarë kanë qenë këto kontakte dhe nëse ka
9 pasur ndonjë deklaratë apo ndonjë procesverbal apo ndonjë
10 dokumentacion tjetër të këtyre kontakteve të mëparshme.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të paktën një tjetër për
12 të cilin ne jemi në dijeni, zoti Cadman, është shënimi që ka
13 përmendur Prokuroria, datë 28 janar, të vitit 2021. Pra ky do
14 të ishte kontakti tjetër. Prokuroria duhet ta mbajë parasysh
15 këtë kur të shqyrtojë dokumentacionin e vet, për të parë nëse
16 ka ndonjë gjë që do të përbënte ndonjë deklaratë të
17 dëshmitari, nëse nuk e kanë bërë këtë tashmë. Ju falënderoj,
18 zoti Cadman.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Zoti Halling, për të
20 sqaruar, nuk e dëgjova qartë përgjigjen për qëndrimin që do të
21 mbani ju sa i takon deklaratës, intervistës më saktë, me
22 dëshmitarin.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ne po i shtojmë të gjitha
24 transkriptet e intervistave të dëshmitarëve në listën e
25 materialeve. Këtë e bëjmë se, për sa i takon paqartësive të

1 një procedure penale, nuk e dimë se kur mund t'i parashtrojmë
2 si prova.

3 Unë e them tani që ne nuk do përdorim rregullën 153 apo
4 154 sa i takon kësaj interviste. Sigurisht, nëse ai do japë
5 dëshmi në sallë, këtë deklaratë nuk do ta paraqesim si provë
6 materiale.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të sqarojmë se për
8 ç'qëllim e shtoni në listën e provave materiale?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Ta zëmë - dhe po flas në mënyrë
10 hipotetike, ta zëmë se ndodhemi në situatën ku mund të dalë
11 qartë se ky dëshmitar mund të bëhet objekt i ndërhyrjes që do
12 të thotë se do të hyjë në lojë rregulla 155, nëse do të ketë
13 fakte për këtë. Ne na duhet ta shtojmë këtë në listën e
14 provave materiale nëse do të na duhet ta parashtrojmë si
15 provë. Prandaj edhe këtë e bëjmë me të gjithë dëshmitarët
16 tanë.

17 Kjo nuk do të thotë se po i paraqesim si prova materiale
18 aktualisht apo se kemi ndërmend, por thjesht duam që të
19 informojmë Mbrojtjen që i kemi edhe këto, në mënyrë
20 alternative, si një provë të mundshme materiale.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, zoti Halling.

22 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Në rregull, kalojmë te tema
23 tjetër, që është data e hapjes së paraqitjes së provave nga
24 ZPS-ja dhe deklarata e çeljes.

25 Javën që shkoi unë bëra të ditur se kemi ndërmend ta

1 hapim këtë çështje gjyqësorë, të enjten, 7 tetor 2021 dhe apo
2 të ditë do të dëgjojmë deklaratën hapëse të ZPS-së. Mbrojta po
3 kështu na bëri të ditur javën që shkoi se nuk kanë ndërmend të
4 mbajnë deklaratën hapëse menjëherë mbas Prokurorisë. Të dyja
5 ekipet e mbrojtjes na e thanë këtë por po mendoj që të bëjmë
6 një deklaratë hapëse përpara se të bëhet paraqitja e provave
7 të mbrojtjes.

8 Zoti prokuror, data 7 tetor është në rregull për ju për
9 të mbajtur deklaratën hapëse dhe për të hapur çështjen
10 gjyqësore?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti Rees, zoti Cadman, a i
13 qëndroni qëndrimin tuaj se nuk dëshironi që të mbani deklaratë
14 hapëse menjëherë mbas ZPS-së dhe se data 7 tetor është në
15 rregull për ju që ZPS-ja ët mbajë deklaratën hapëse, zoti
16 Rees?

17 Z. REES: [Përkthim] Po.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, i nderuar gjykatës.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Përpara se të pyes ZPS-së
21 lidhur me kohëzgjatjen e deklaratës hapëse, zoti Rees, zoti
22 Cadman, a mund të na bëni të ditur se nëse ju dëshironi që
23 prokuroria të lexojë të gjithë akt akuzën në hapjen e tyre apo
24 vetëm pjesë të akuzave të janë pjesë të paragrafëve 47 dhe 48
25 të aktakuzës.

1 Zoti Rees?

2 Z. REES: [Përkthim] Ne mendojmë se duhet lexuar e gjithë
3 akt akuza në publik sepse ky është një gjyq publik. E gjithë
4 aktakuza në tërësi paraqet pretendimet dhe se si ZPS-ja i ka
5 përshkruar ato.

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman?

7 Z. CADMAN: [Përkthim] E mbështes qëndrimin e kolegut.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Atëherë zoti prokuror, tani e
9 dini se çfarë që duhet që të shtoni në deklaratën hapëse. Sa
10 mendoni se do të zgjasë deklarata hapëse në total?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Ne parashikojmë që
12 fjala hapëse të jetë dy deri në tre seanca, rreth katër orë.
13 Do të ketë material audio-viziv dhe ne mund ta paraqesim këtë
14 deklaratë hapëse kur të dëshironi ju.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mendoni se mund ta mbyllni
16 këtë brenda datës 7, brenda të njëjtës ditë?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Duke pasur parasysh që do lexohet
18 e gjithë aktakuza, do jetë e vështirë por mendoj se është e
19 mundshme.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ku propozoni që të përdorni
21 disa materiale të propozuara. A mund t'i jepni njoftim 24 orë
22 Mbrojtjes dhe Trupit Gjykses përpara se cilat prova materiale
23 dëshironi të përdorni për këtë qëllim dhe minutazhin përkatës,
24 nëse do të jetë video?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Por dua të sigurohem

1 që e kuptoj urdhrin. Njoftimin për vulën kohore, kur thoni
2 minutazh? Po, këtë mund ta bëjmë.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Trupi Gjykues
4 do të japë një urdhër gojarisht sot.

5 Kemi kaluar në pikën tjetër që është koha që kemi në
6 dispozicion, për paraqitjen e provave nga ZPS-ja. Vë re se
7 koha që vlerëson ZPS-ja për dy dëshmitarët është 15 orë për
8 pyetjet kryesore, 10 orë për dëshmitarin 4841 dhe 5 orë për
9 dëshmitarin 4842.

10 Për dëshmitarin shtesë, nëse Trupi Gjykues do t'a
11 miratojë këtë kërkesë, ata vlerësojnë se kërkojnë 3 orë marrje
12 në pyetje.

13 Ndërsa javën që shkoi unë bëra të ditur që kemi ndërmend
14 që të dëgjojmë provat në javën që fillon më 18 tetor dhe në
15 javën që fillon me 25 tetor. Pra ekziston mendësia katër ditë
16 në secilën nga këto dy javë.

17 Zoti prokuror, sipas cilit rend synoni që t'i thërrisni
18 dëshmitarët dhe sa ditë parashikoni se do të kërkojë marrja e
19 tyre në pyetje në sallë, nëse kemi parasysh që do të mblihdemi
20 këtu nga ora 09.30 deri në 16.00 dhe a mendoni se do të
21 thërrisni dëshmitarin për të cilin keni kërkuar ta shtoni në
22 listë, nëse do ta miratojmë këtë kërkesë?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
24 ju e thatë shumë saktë vlerësimin e kohës. Këto vijojnë të
25 jenë të vërteta. Dëshmitari 4841 është sipas një rregulle

1 përkatëse, tjetri do të jetë viva-voce. Ne parashikojmë katër
2 ditë marrje në pyetje.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Sipas cilit rend?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Rendi që parashikojmë është që të
5 thërrasim në fillim 4841, 4866 dhe pastaj 4842. I nderuar
6 Gjykatës përmendi që dëshmitari numër 4866 do të jetë i
7 fundit.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Arsyeja pse sugjeruam kështu
9 që të jetë i fundit është për shkak të faktit që është futur
10 tani vonë dhe lidhur me kundërshtimet e mundshme që mund të
11 bëjë mbrojtja.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Në një gjyq më të gjatë kjo do të
13 ishte problem por në një rast të tillë nuk kemi problem për
14 këtë renditje.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Zoti Rees, javën që shkoi ju ofruat një vlerësim maksimal
17 12 ditë për kundrapyetjet për dy dëshmitarët e parë të ZPS-së.
18 Si ndryshon ky vlerësim tani nëse Trupi Gjykses miraton
19 kërkesën për të shtuar një dëshmitar të tretë. Dhe duke pasur
20 parasysh përgjigjen e Prokurorisë dhe disponibilitetin e tetë
21 ditëve kur do të mbahen seancat që përmenda, deri ku mund të
22 arrini me këto kundrapyetje? Unë do shpresoja që ta mbyllnim
23 paraqitjen e provave të Prokurorisë brenda këtyre dy javëve që
24 kemi në dispozicion prandaj, ju lutem të na jepni edhe
25 vlerësimin dhe dëshirën tuaj, të na e tregoni.

1 Z. REES: [Përkthim] Kundra pyetjet lidhur me dëshmitarin
2 e tretë që na propozohet nga ana ime do të ishin relativisht
3 të shkurtra. Mbase jo më shumë se një seancë. Pra nuk e
4 ndryshon shumë atë vlerësim që kam dhënë javën që shkoi.

5 Por e kam bërë të qartë që unë isha pesimist, unë po
6 flisja për skenarin më të keq të themi, gjithsesi unë mendoj,
7 pavarësisht se mund të përpiqemi që ta mbyllim paraqitjen e
8 provave nga Prokuroria brenda fundit të tetori, brenda fundit
9 të javës së dytë, por unë gjithsesi mendoj se kjo nuk ka gjasa
10 të ndodhë.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam shumë për t'i shtuar kësaj.
12 Thjesht për të ritheksuar edhe një herë atë që thamë javën që
13 shkoi, pasi na pyeti Trupi Gjykses që një pjesë e mirë e
14 kundërpvetjeve nuk është se zoti Rees do të bëjë pyetje
15 tjetër. Ne do të përpiqemi që t'i bashkojmë pyetje tona sa më
16 shumë, por jam dakord me pesimizmin e zotit Rees për sa i
17 takon mbylljes brenda dy javëve.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju nxisim gjithmonë që të
19 diskutoni sa i takon bashkimit të kundrapvetjeve sa më shumë
20 dhe e kuptojmë se jo gjithmonë është e mundshme kjo.

21 Z. HALLING: [Përkthim] A mund t'u përgjigjem vlerësimeve
22 të Mbrojtjes?

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Patjetër.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Mbrojtja ka të
25 drejtë që të ketë mundësinë e drejtë për t'u bërë kundërpvetje

1 dhe sapo është thënë edhe nga Mbrojtja dhe të dyja ekipet e
2 Mbrojtjes kanë një interes të ngjashëm dhe edhe kufiri i
3 kundërpyetjeve duhet a reflektojë këtë.

4 Duke pasur parasysh vlerësimin për shtatë ditë për njërin
5 dhe shtatë ditë për tjetrin, janë të tepruara, qartë, nëse
6 palëve u jepet një kohë joproporcionale nuk është e drejtë,
7 duke pasur parasysh edhe atë që thotë rregulla 143-144 që i
8 jep Kryegjykatësit kompetencën për të ushtruar kontroll mbi
9 bërjen e pyetjeve dhe për të shmangur ngacmimin që u bëhet
10 gjyqtarëve. Prandaj dhe deshëm që të sjellim në vëmendjen tuaj
11 letë gjë.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Procesi i vendosjes së këtyre
13 kufijve është kur dëgjojmë vlerësimet e të gjithëve dhe këto i
14 marrim parasysh se çfarë kërkohet. Ne seriozisht do t'i marrim
15 parasysh të gjitha ato që u thanë këtu dhe do të marrim një
16 vendim vetë të cilin do ta paraqesim sa më shpejtë.

17 Z. REES: [Përkthim] A mund të jap një përgjigje të
18 shpejtë?

19 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po ju e thatë ishte vlerësimi
20 më pesimist dhe unë e mora parasysh këtë gjë.

21 Z. REES: [Përkthim] Ju falënderoj. Arsye pse është
22 pesimiste është kjo: duke mbajtur gjithmonë parasysh edhe
23 rezervat por duke qenë edhe realistë, janë kundërpyetje për dy
24 dëshmitarë, njëri prej të cilëve ka nëntë shtylla, 400 rreshta
25 me materiale që nuk i janë nxjerrë Mbrojtjes dhe e vetmja gjë

1 që mund të bëj, unë e kuptoj që ky është një mocion për të
2 cilin nuk është marrë vendim, mbase nuk do të na duhet që ta
3 trajtojmë gjatë procesit gjyqësor sepse pranueshmëria është
4 kundërshtuar. Por, një prej çështjeve është edhe vështirësia
5 me të cilën ka hasur Mbrojtja për ta kundërshtuar këtë
6 material.

7 Por mua do më duhet që ta marr rresht për rresht, shtyllë
8 për shtyllë, këtë listë.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. E kemi
10 parasysh. Ju e përmendët javën që shkoi kur bëtë parashtrimet
11 tuaja. E mbajtëm parasysh.

12 [Trupi Gjykses këshillohet me administratën e gjykatës]

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Dua tani t'u kërkoj palëve të
14 na japin një vlerësim lidhur me përfundimin e gjyqit siç
15 diskutuam javën që shkoi, në kushte ideale dhe besoj që të
16 gjithë ranë dakord kjo do të ndodhte në fund të vitit, pra në
17 mes të dhjetorit, që është edhe koha kur Gjykata bën një
18 pushim. A do të ishte realist një afat i tillë? Sigurisht
19 gjatë ecurisë së çështjes së çështjes edhe mund të ndryshojë.

20 Zoti Halling?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Lidhur me paraqitjen e dëshmimeve
22 nga ne si Prokurori, ne duhet të jemi në gjendje të
23 përfundojmë në fund të tetorit, kështu që mbetet nëntori dhe
24 dhjetori për pyetjet e mbrojtës.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Zoti Rees?

2 Z. REES: [Përkthim] Unë i përmbahem të njëjtit qëndrimi
3 që thash javës që shkoi.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë.

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të japim një urdhër me
6 gojë për këtë, ku do të përcaktojmë të gjitha datat.

7 Kemi ardhur në fund të programit që ju kemi dërguar.
8 Paneli dëshiron të trajtojë një çështje lidhur me parashtrimin
9 e Prokurorisë për klasifikimin e provave materiale që është
10 një pikë shtesë dhe këto çështje do t'i trajtojë Jykatësi
11 Mettraux. Faleminderit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkurt. Pyetja është për
13 mbrojtjen kryesisht. Në 6 shtator 2021 ZPS-ja parashtroi një
14 kërkesë për klasifikimin e provave të propozuara. ZPS-ja
15 identifikon tre kategori lidhur me të cilat kërkohet redaktim.

16 1) Pamjet e materialeve që janë nxjerrë në mënyrë të
17 paligjshme nga të akuzuarit; 2) emrat e stafit të ZPS-së të
18 tjerë nga të dy dëshmitarët e propozuar, të cilët do të
19 thirren nga ZPS-jaë; dhe 3) letra të dërguara dhe të marra nga
20 organizata ndërkombëtare lidhur me bashkëpunimin hetimor.

21 Përpara se të dëgjojmë Mbrojtjen, këto kategori, zoti
22 Rees dhe zoti Cadman, duken *prima facie* të jenë të arsyeshme
23 për aq sa juve ju është dhënë material pa redakte sigurisht
24 dhe se këto redakte kërkohen në mënyre ekskluzive për
25 publikun në përgjithësi. Pra *prima facie* duket në plan të parë

1 duket sikur nuk ndërhyjnë me mundësinë tuaj për të përmbushur
2 mandatin dhe mundësitë që ju janë dhënë në mënyrë efikase.

3 Sigurisht unë kam parasysh se provat do të shihen gjatë
4 rrugës dhe është zbatimi në praktikë i këtyre redaktimeve të
5 propozuara që mund të përbëjnë problem. Propozimi që kemi për
6 ju është që Mbrojtja të diskutojë me Prokurorinë natyrën e dhe
7 fushëveprimin, shkallën e redaktimeve të propozuara të cilat
8 do të bëhen në bazë të kësaj kërkesë, me idenë për të arritur
9 një marrëveshje midis palëve për atë që duhet redaktuar dhe
10 për të njoftuar Dhomën apo Panelin nëse është arritur një
11 marrëveshje e tillë.

12 Nëse jo, masën deri ku keni mosmarrëveshje lidhur me
13 procesin për ju zoti Rees tani dhe zoti Cadman?

14 Z. REES: [Përkthim] Po, jam i kënaqur për t'i zgjidhur
15 çështjet *inter parte* me ZPS-në dhe do të bëjmë maksimumin
16 tonë.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë jam dakord.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për
19 mirëkuptimin.

20 Zoti Halling, besoj që edhe ju do të bashkoheni me frymën
21 e mirë të bashkëpunimit me mbrojtjen.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Pa dyshim.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Paneli do t'i urdhërojë palët
24 të diskutojnë këtë çështje së bashku, duke u orvatur të
25 arrijnë një marrëveshje dhe ta informojnë Panelin për një

1 marrëveshje të tillë apo për ndonjë çështje të pazgjidhur deri
2 në 20 shtator 2021. Paneli do të nxjerrë një urdhër me gojë në
3 këtë drejtim në fund të konferencës me idenë për ta
4 përshpejtuar çështjen.

5 Tani do të bëjmë një 20 minuta për të diskutuar për
6 urdhrin me gojë dhe për t'ua dhënë atë urdhër juve kështu që
7 në orën 12Ë30 kthehuni përsëri dhe do të vazhdomë dhe do ta
8 mbyllim për sot. Për tani bëjmë pushim.

9 Të gjithë në këmbë.

10 --- Pauza fillon në orën 12.07

11 --- Seanca rifillon në orën 12.29

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykues nxjerr këto
13 urdhra gojorë.

14 Urdhri i parë.

15 Pasi janë shqyrtuar argumentet e ngritura nga secila prej
16 palëve dhe sa i takon në veçanti kërkesës së ZPS-së për të
17 shtuar një dëshmitar të ri në listën e dëshmitarëve, Trupi
18 Gjykues e pranon këtë kërkesë. Po ashtu ne do të marrim dhe
19 parasysh edhe parashtrimet të cila janë parashtruar nga ZPS-
20 ja.

21 Si rezultat i rregullit 118(a) Paneli vendosi që ZPS-ja
22 mund të thërrasë tre dëshmitarë për paraqitjen e çështjes së
23 saj. Përkatësisht dëshmitari 4841, 4842 dhe 4866. Trupi
24 Gjykues e urdhëron më tej ZPS-në që të thërrasë dëshmitarin
25 4866 si dëshmitarin e fundit në mënyrë që t'i lejojë kohë të

1 mjaftueshme Mbrojtjes për të marrë në kundërpyetje këtë
2 dëshmitar.

3 ZPS-ja duhet që të dorëzojë deri në 1 tetor të vitit 2021
4 listën e dëshmitarëve sipas urdhrit në të cilën ata do të
5 merren në pyetje prej Prokurorisë.

6 Ky është fundi i urdhrit të parë gojor.

7 Urdhri i dytë.

8 Pasi kemi dëgjuar palët dhe në pajtime rregullin 118
9 (3), Trupi Gjykues përcakton datën për çeljen e çështjes si
10 data 7 tetor i vitit 2021. Më tej në pajtim me rregullën
11 124(2) dhe parashtrimet e Mbrojtjes sa i takon hapjes së
12 çështjes, ZPS-ja do të lexojë aktakuzën, versionin e
13 korigjuar, siç është depozituar më 5 korrik [siç u përkthye]
14 të vitit 2021.

15 ZPS-ja do të japë deklaratën hapëse më 7 tetor dhe do të
16 përpiqet që të përfundojë deklaratën e tillë brenda kësaj
17 date.

18 Ne urdhërojmë gjithashtu ZPS-në që ajo t'i japë Mbrojtjes
19 listën e provave materiale të propozuara brenda 24 orëve
20 përpara hapjes së çështjes, përfshirë këtu edhe videot të cila
21 planifikohen që të përdoren si prova materiale prej ZPS-së.

22 Prezantimi i ZPS-së duhet të përfundojë me 18 tetor 2021.

23 ZPS-ja duhet të përfundojë marrjen në pyetje të
24 dëshmitarëve të saj brenda 4 seancave dhe po ashtu Trupi
25 Gjykues nuk do të përcaktojë një kohë aktuale të përcaktuar sa

1 i takon kundërpyetjeve të Mbrojtjes, por do të ndërhyjë në
2 qoftë se është e nevojshme sa i takon kësaj kohe.

3 Më tej, duke dëgjuar palët, Trupi Gjykues përcakton
4 si datën e synuar për mbylljen e çështjes së ZPS-së datën 9
5 nëntor të vitit 2021.

6 Ne po ashtu përcaktojmë si datën e synuar për mbylljen e
7 të gjithë çështjes datën 17 dhjetor të vitit 2021. Këto dy
8 data mund të ndryshohen në varësi të zhvillimit të
9 procedurave.

10 Ky është fundi i urdhrit të dytë të Trupit Gjykues

11 Ju kërkoj ndjesë sepse siç duket e kam thënë gabim datën
12 e aktakuzës së korigjuar dhe korigjimi është data 5 korrik
13 2021.

14 Ky është fundi i urdhrit të dytë. Urdhri i tretë.

15 Trupi Gjykues urdhëron palët që të diskutojnë çështje që
16 të kanë të bëjnë me klasifikimin e provave materiale sa i
17 takon kërkesës për prova të drejtpërdrejta për Trupin Gjykues
18 dhe të përpiqen që të arrijnë marrëveshje.

19 Deri në 20 shtator të vitit 2020 [siç u përkthye] do të
20 informojnë Trupin Gjykues për marrëveshjen e tyre dhe çështje
21 të cilat nuk janë zgjidhur ndërmjet palëve.

22 Fundi i urdhrit të tretë është ky.

23 Ndërkohë së fundi më lejoni të them që neve më tej
24 lejojmë parashtrimet me shkrim sa i takon elementeve të
25 veprave penale formave të përgjegjësisë penale.

1 Në veçanti pranojnë parashtrime të cilat lidhen me pyetje
2 specifike që kanë të bëjnë me pengimin dhe marrëdhëniet
3 ndërmjet formave të përgjegjësisë penale të cilat janë të
4 parashikuar në aktakuzë.

5 Flitet për transkriptin në kohë reale, në faqen 24,
6 rreshti 24 deri në 25, faqja 25, rreshti 1 deri në 6, faqja
7 25, rreshti 1 deri në 15, faqja 42, rreshti 16 deri në 18,
8 faqja 43, rreshti 20 deri në 21.

9 Parashtrimi duhet që të dorëzohet deri me 30 shtator të
10 vitit 2021.

11 Ky është fundi i urdhrorit të katërt me gojë dhe ky është
12 fundi i seancës për ditën e sotme.

13 Zoti Rees, doni të thoni diçka?

14 Z. REES: [Përkthim] Po, kam diçka e cila është thjesht
15 çështje administrative por e cila mendoj që do të ndihmojë sa
16 i takon planifikimit për gjykimin. Së pari, sa i takon dy
17 javëve në fund të tetori, do të donin të dinim se për cilat
18 data bëhet fjalë, domethënë cilat janë ato dy ditët gjatë
19 këtyre dy javëve në të cilat ne nuk do të kemi seanca. A mund
20 të na thoni?

21 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani plani është që ne të
22 takohemi nga e hëna deri të enjten dhe nuk do të takohemi të
23 premtën e javës së parë dhe të premtën e javës së dytë. Pra ka
24 shumë arsye pse e kemi planifikuar të paktën kështu, por një
25 prej arsyeve është që në qoftë se është e nevojshme për

1 shembull që të kemi seancë të premtën, në qoftë se ka diçka që
2 nuk e kemi përfunduar të enjten, sigurisht që mund të
3 vazhdojmë edhe të premtën.

4 Z. REES: [Përkthim] Mirë në rregull. Faleminderit. Sa i
5 takon periudhës së mëpasshme, pra ato dy ditët në javë që do
6 të kemi në dispozicion, a kemi ndonjë ide se cilat janë këto
7 dy ditët e javës apo jo?

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Në konsultim ndërmjet nesh
9 dhe Trupit Gjykses numër 1, ne kemi përcaktuar nëntorin dhe
10 dhjetorin sepse ka disa kohë që njerëzit nuk janë të
11 disponueshëm kështu që do të mundohemi që sa i takon datave
12 specifike, në momentin kur të kemi përcaktuar këto sata, do
13 t'ua vëmë në dispozicion në mënyrë që të mund të bëni planet
14 tuaja. Ka disa javë në të cilat mund të punojmë dy ditë. Për
15 shembull, ka edhe një javë kur mund të kemi katër ditë të
16 plota dhe e kam fjalën këtu për dhjetorin, në qoftë se është e
17 nevojshme.

18 Pra me fjalë të tjera, do të mundohemi që të kemi
19 kalendarin e përfunduar dhe do t'ju japim një njoftim. Dhe
20 ndërkohë, siç ju kemi thënë edhe një herë, është e vështirë
21 pasi ne duhet të koordinohemi me Trupin Gjykses të çështjes
22 tjetër dhe të sigurohemi që salla është në dispozicionin tonë.

23 Edhe njëherë më lejoni të them që në momentin kur të kemi
24 më shumë informacion, do t'ju drejtohem.

25 Faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen tuaj,

1 Faleminderit për përgatitjen e mirë. Faleminderit për
2 mirësjelljen, e vlerësojmë shumë dhe do të shihemi së shpejti.

3 Faleminderit dhe ky është fundi i kësaj seance. Seanca
4 mbyllet këtu.

5 --- Konferenca Përgatitore e Prokurorisë

6 mbyllet në orën 12.38

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25